



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosova
Qeveria/Vlada/Government

Ministria e Punëve të Brendshme/
Ministarstvo Unutrašnjih Poslova/Ministry of
Internal Affairs



Policia e Kosovës/Policija Kosova/Kosovo Police

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë
Generalna Direkcija Policije/General Directorate of
Police

Në mbështetje të nenit 1, nenit 33 si dhe nenit 37 paragrafi 7 të Ligjit Nr. 04/L-76 për Policinë (Gazeta Zyrtare, nr. 04/19 Mars 2012), Drejtori i Përgjithshëm i Policisë, nxjerr:

RREGULLORE
PËR OPERATIVË NË POLICINË E KOSOVËS

KAPITULLI I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i kësaj Rregulloreje është përmbledhja dhe unifikimi i akteve nënligjore të Policisë së Kosovës (rregulloreve dhe parimeve dhe procedurave të Policisë), të cilat kanë të bëjnë me punët operative të Policisë së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Policia).

Neni 2
Fushëveprimi

1. Kjo Rregullore përcakton rregullat dhe procedurat lidhur me mbajtjen e rendit dhe qetësisë publike, bartjen e armës, sigurimin e lëvizjes së lirë, mbrojtjen e pronës, zbulimin e veprave penale dhe kryesve të këtyre veprave, kontrollimin e kufirit, patrullimit, arrestimit dhe ndalimet policore, trajtimin e personave me aftësi të kufizuar dhe të fëmijëve, sigurimin e objekteve dhe personaliteteve të caktuara, trajtimi i rasteve me mjete shpërthyes, inspektimi, auditimi, si dhe çështje tjera që kanë të bëjnë me punët operative të Policisë, të cilat nuk janë të rregulluara me udhëzime administrative në fuqi.

2. Dispozitat e përcaktuara me këtë Rregulloreje janë të obligueshme për të gjithë zyrtarët policor, pa marr parasysh gradën dhe pozitën e tyre në Polici.

KAPITULLI II PATROLLIMI

Neni 3 Patrullimi Policor

1. Patrullimi është veprim policor, përmes të cilit mbahet rendi dhe qetësia publike, bëhet sigurimi i pronës, lëvizjes së lirë, kontrollimi i kufirit, rregullimin e trafikut, parandalimin dhe zbulimin e veprave penale, kapjen e kryesve të veprave penale, si dhe veprimeve dhe aktiviteteve tjera nga fusha e sigurisë, të cilat bëhen nga policia në zbatim të ligjit.
2. Zyrtarët policorë me rastin e patrullimit janë të obliguar që t'i zbatojnë të gjitha aktet normative në fuqi, si dhe janë të obliguar që t'u përgjigjen të gjitha rasteve të cilat kanë të bëjnë me rendin dhe sigurinë.

Neni 4 Përbërja dhe aktiviteti i patrullës policore

1. Patrullimi policor bëhet brenda hapësirës territoriale e cila është nën përgjegjësinë e stacionit, apo ndonjë njësi tjetër policor.
2. Ekipet patrulluese kryesisht patrollojnë në këmbë, duke qëndruar në vende publike të dukshme, në mënyrë që prezenca e tyre të ndikojë pozitivisht në sigurinë e qytetarëve, si dhe të jetë si proaktive në parandalimin e veprimeve të kundërligjshme. Shpërndarja e ekipeve patrulluese bëhet varësisht prej nevojave dhe situatës.
3. Me rastin e patrullimit me automjet policor duhet të përdoren automjetet të cilat i kanë tabelat dhe simbolet policore, përfshirë edhe pajisjet emergjente. Para se të fillojë patrullimi, zyrtari policor i cili ngarkohet me automjetin patrullues duhet të sigurohet se automjeti dhe pajisjet emergjente të jenë në gjendje të rregullt. Gjatë përdorimit të automjetit policor duhet të përkujdesen për sigurinë e të gjithë personave, pa marrë parasysh rrethanat ekzistuese. Asnjë intervenim me automjetin policor nuk arsyetohet nëse me atë rast rrezikon veten apo sigurinë publike, pa marrë parasysh rrethanat emergjente.
4. Nëse gjatë patrullimit njësitet patrulluese ballafaqohen me ndonjë problem apo rast emergjent dhe zyrtari policor e vlerëson se ka nevojë për ndihmë/asistencë nga policët tjerë, atëherë përmes qendrës së komunikimit (bazës) duhet të kërkohet asistencë apo ndihma policore.
 - 4.1. Zyrtari policor i cili i ofron asistencë njësitit patrullues, duhet të jetë në mbështetje derisa të përfundon/zgjidhet rasti, ose derisa situata të vihet nën kontroll;
 - 4.2. Zyrtari policor i cili ka kërkuar ndihmë/asistencë policore është përgjegjës për rastin, përderisa i njëjti të shkarkohet apo zëvendësohet me kërkesën e mbikëqyrësit apo ndonjë epror tjetër më i lartë apo kur rasti/problemi përfundon apo zgjidhet.

Neni 5 Zona e përgjegjësisë

1. Zyrtarët policorë patrullues, respektivisht sektorët policorë duhet të jenë në dijeni për: hapësirën territoriale, e cila i takon stacionit policor, njohuri për rrugët dhe rreziqet në trafik, si dhe njohuri tjera të cilat nuk kufizohen vetëm në:

Emrat e personave të dyshimtë, personave me të kaluar kriminale, vendet ku ata banojnë dhe ku zakonisht qëndrojnë;

1.1. Selitë e gjykatave dhe prokurorive;

1.2. Institucionet e Shërbimeve Sociale, dhe

1.3. Spitalet, ambulancat dhe organizatat tjera shëndetësore që kujdesen për shëndetin e popullsisë.

2. Udhëheqësit e njësiteve patrulluese, sipas nevojës hartojnë plane të ndryshme operative për situata/raste të veçanta.

3. Zyrtarët policorë gjatë patrullimit dhe ndalimit të personave dhe automjeteve të dyshimta duhet të jenë të kujdesshëm nga rreziqet e mundshme të cilat mund të jenë të natyrës të ndryshme.

4. Gjatë patrullimit apo rregullimit të trafikut dhe ndaljes së automjeteve motorike, zyrtarët policorë janë të obliguar që ta bartin jelekun reflektues, ndërsa në orët e mbrëmjes t'i përdorin edhe bateritë me drita fluoreshente.

Neni 6

Rregullat e komunikimit me rastin e ndalimit

Zyrtarët policorë me rastin e ndaljes së kundërvajtësit apo personit të dyshimtë duhet të evitojnë komentet dhe polemikat e panevojshme me kundërvajtësin. Në këto raste ndaj kundërvajtësit kryhen veprimet të cilat nuk kufizohen vetëm në:

a) Arsyerja e ndaljes;

b) Kundërvajtja e shkaktuar;

c) Kërkimi i dokumentacionit identifikues;

d) Rrezikun të cilin ajo kundërvajtje e paraqet për publikun;

e) Kërkesën për kundërvajtje dhe gjykatën e cila është kompetente të vendosë.

Neni 7

Kufizimi i përkohshëm i lirisë së lëvizjes

1. Zyrtarët policorë, nëse është e nevojshme gjatë patrullimit mund të vendosin kufizime dhe pengesa në rrugë, mirëpo paraprakisht duhet të lejohet nga mbikëqyrësi i patrullës.

2. Kufizimet dhe pengesa nga paragrafi paraprak mund të vendosen në rrethanat të cilat nuk kufizohen vetëm:

2.1. Kur kemi të bëjmë me fatkeqësi të rënda ose me ndonjë katastrofë natyrore apo të shkaktuara nga faktori njeri, e të cilat paraqesin rrezik për qytetarët;

2.2. Për të bërë kontrollin e automjeteve dhe të sigurisë së trafikut;

2.3. Për të bërë kërkimin apo kontrollin e personave të dyshimtë, personave të dënuar apo të arratisur.

3. Pa lejen apo autorizimin e mbikëqyrësit, vendosja e pengesave në rrugë mund të iniciohet vetë kur: jeta dhe siguria e zyrtarit policor dhe e personave tjerë është në rrezik, për të bërë kapjen e ndonjë personi të dyshimtë apo të kërkuar i cili është i rrezikshëm, për të penguar dëmtimin apo asgjësimin e pasurisë me përmasa të mëdha.

Nëse për shkak të këtyre rrethanave vendosen pengesat, atëherë policët patrullues sa më parë që të jetë e mundur duhet ta informojnë eprorin apo mbikëqyrësin më të lartë.

4. Nëse vendosen pengesat në rrugë, është e nevojshme që paraprakisht të bëhet vlerësimi i situatës dhe të zgjidhet vendi sa më i përshtatshëm për sigurinë e zyrtarëve policorë dhe për qytetarët se ku duhet të vendosen pengesat.

Neni 8 **Patrullimi me biçikleta**

1. Patrullimi policor mund të bëhet me biçikleta të policisë. Ky lloj patrullimi është shumë praktik dhe efikas dhe kryesisht aplikohet në qytet ku trafiku dhe frekuentimi i qytetarëve është i madh.

2. Policët të cilët punojnë në njësitin e biçikletave duhet të jenë të trajnuar dhe të certifikuar në përdorimin e biçikletave.

3. Patrulla policore me biçikleta përbëhet prej së paku prej dy zyrtarëve policorë, mirëpo në rrethana të caktuara, me lejen e udhëheqësit të kësaj njësie mund të patrollojnë edhe vetëm.

Neni 9 **Përdorimi i motoçikletave**

1. Ekipi i Motoçikletave përveç patrullimit angazhohet edhe për kontrollim të trafikut, përcjelljen e personaliteteve të rëndësishme, delegacioneve diplomatike, si dhe raste tjera sipas nevojës.

2. Patrullimi me motoçikleta policore bëhet varësisht nga kushtet klimatike. Nëse moti është i keq dhe paraqet rrezik shtesë për policin me motoçikletë, zyrtari përgjegjës për operacione është përgjegjës që të vendosin se kur (në cilat ditë) zyrtarët policë do të operojnë me motoçikleta.

2.1. Operimi me motoçikleta fillon me 15 Mars dhe përfundon me 15 Nëntor, por nuk mund të përdoren kur temperaturat janë më të ulëta se 3 gradë celsius;

2.2. Përrjashtimisht brenda afati kohor nga nënparagrafi 2.1, motoçikletat mund të përdoren nëse kërkohet nga niveli më i lartë në Polici.

3. Përdorimi i motoçikletës policore në operacionet e ndjekjes është i ndaluar, përveç në rrethana kur zyrtari policor vlerëson se ikja e të dyshimitit apo e autorit të krimit paraqet një rrezik të lartë dhe të drejtpërdrejtë për personat tjerë dhe për vetë zyrtarin policor.

4. Zyrtari policor i cili me motoçikletë është në ndjekje të ndonjë vozitësi të automjetit të dyshimtë është i obliguar që ndjekjen ta ndërpresë menjëherë pasi që automjeti policor të vijë dhe ta marrë përsipër përgjegjësinë për ndjekje.

Neni 10

Ndalja e automjeteve

1. Ndalja e automjeteve për shkak të kundërvajtjeve në trafik apo për qëllime tjera në të shumtën e rasteve konsiderohet si detyrë e rregullt e zyrtarëve policorë patrullues. Për shkak të rreziqeve me të cilat ballafaqohen me rastin e ndaljes zyrtarët policorë duhet të jenë të kujdesshëm dhe t'i ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme të ndaljes, në mënyrë që pjesëmarrësit tjerë në trafik dhe vetë zyrtarët policorë të mos rrezikohen.

2. Me rastin e ndaljes së automjeteve në trafikun rrugor, zyrtarët policorë duhet ta kenë parasysh situatën dhe rrethanat në trafik, si: llojin e rrugës, dendësinë apo frekuencën në trafik dhe urgjencën për ndaljen e automjeteve, në mënyrë që pastaj të përcaktohen për teknikat, taktikat, metodat dhe procedurat të cilat do t'i aplikojnë me rastin e ndaljes së automjeteve.

Neni 11

Ndalimi i automjeteve me rrezikshmëri të lartë

1. Nëse gjatë patrullimit, zyrtarët policorë me arsye besojnë se është e nevojshme që të ndalet ndonjë automjet për shkak të dyshimit se personi është i përfshirë në ndonjë krim, ose të dyshimit se në të janë personat në kërkim, atëherë duhet të ndërmarrë veprimet të cilat nuk kufizohen vetëm në:

1.1. Njoftimin e qendrës së komunikimit për rastin apo arsyen e ndaljes, të sigurojë informata lidhur me automjetin në fjalë, numrin e udhëtarëve, si dhe nëse është e nevojshme të kërkojë ndihmën e duhur për të bërë ndaljen.

1.2. Zyrtari policor nuk duhet të iniciojë ndaljen e automjeteve me rrezikshmëri të lartë, përderisa nuk janë gati njësitet mbështetëse, përveç në rastet urgjente ku për shkak të rrezikshmërisë kërkohet veprim i menjëhershëm.

1.3. Zyrtari policor i cili e ka nisur ndaljen, apo zyrtari policor i cili e ka pozitën më të mirë të vëzhgimit, duhet përmes sistemit të komunikimit (megafonit) ta urdhërojë ndaljen. Vetëm një polic duhet të japë urdhra dhe menjëherë pas ndaljes, zyrtarët policorë duhet sa më shpejtë që të jetë e mundur të dalin nga automjetet e tyre dhe të marrin pozicionet e duhura për mbrojtje eventuale.

1.4. Pas ndaljes, personi i ndaluar duhet t'i zbatojë urdhrat e policit të cilat nuk kufizohen vetëm në këto veprime:

- a) Të ulë xhamin e dritares;
- b) Të ngritë duart lart mbi timon;
- c) Që shoferi me dorën e majtë t'i nxjerrë çelësat dhe t'i hedhë në tokë;
- d) Të hapë derën nga ana e jashtme;
- e) Të dalë nga vetura;
- f) Me duar të ngritura lart të kthehet me shpinë kah zyrtarët policorë;

- g) Të ecë me shpinë prapa derisa të urdhërohet për t'u ndalur dhe pastaj të shtrihet për toke, duke i shtrirë duart anash në mënyrë që t'u vihen prangat; dhe
- h) T'i afrohen me kujdes automjetit të dyshimtë për ta kontrolluar.

Neni 12

Ndalja e automjeteve me mbingarkesë dhe jashtë dimensioneve

1. Nëse zyrtari policor patrullues vlerësojnë se është e nevojshme që të ndalet ndonjë automjet transportues me peshë dhe dimensione tej masës së lejuar, atëherë duhet të zbatohen procedurat vijuese:

- 1.1. Të përcaktohet vendi i cili është më i përshtatshëm dhe më i sigurt për ndaljen e automjetit transportues.
- 1.2. T'i mundësohet shoferit kohë dhe distancë e mjaftueshme për t'u ndalur.
- 1.3. Pas ndaljes, zyrtari policor nga pjesa e prapme i afrohet kabinës së automjetit, duke e shfrytëzuar pasqyrën e jashtme të shoferit për të vëzhguar lëvizjet e shoferit. Në asnjë mënyrë zyrtari policor nuk duhet të hipë në kabinë për të komunikuar me shoferin, por duhet të qëndrojë në pjesën e prapme të derës së shoferit dhe nëse e sheh të arsyeshme të kërkohet nga ai që të dalë nga mjeti transportues.

Neni 13

Ekipet policore me qen

1. Policia, me qëllim të mbajtjes së rendit, parandalimit të krimit, zbulimit të veprave penale dhe kryerësve të këtyre veprave, patrullimit në zonat kufitare, zbulimit të kufomave, substancave narkotike, mjeteve shpërthyesë dhe mjeteve për shkaktimin e zjarrit ka formuar ekipet me qen policorë.

2. Para përdorimit të qenit, zyrtari policor që përdor qenin, duhet t'i ketë të gjitha informatat e nevojshme. Këto informata përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në:

- 2.1. Moshën e individit apo vlerësimi i përafërt;
- 2.2. Natyrën e kundërvajtjes së dyshuar;
- 2.3. Rrezikun e mundshëm ndaj masës apo zyrtarëve policorë në vendngjarje, nëse qeni policor lirohet për të vepruar;
- 2.4. Shkalla e rezistencës; dhe
- 2.5. Mundësia për ikjen/arratisjen e personit të dyshimtë, nëse qeni i policisë nuk angazhohet.

3. Policia e përdorë qenin e policisë për t'i kontrolluar objektet e ndryshme, nëse me arsye besohet se në to është strehuar ndonjë person i kërkuar, substancë narkotike apo mjete shpërthyesë. Në këto raste duhet të aplikohen procedurat si në vijim:

- 3.1. Perimetri i ndërtesës duhet të sigurohet nga zyrtarët policorë;
- 3.2. Të kontaktohet pronari apo përgjegjësi i ndërtesës, në mënyrë që të vërtetohet se a ka banues apo persona të tjerë në atë ndërtesë;
- 3.3. Të përkujdeset që të gjithë banuesit dhe personat tjerë të largohen nga objekti i cili parashihet që të kontrollohet.

4. Ekippet policore me qen mund të angazhohen për kontrollimin e masës me rastin e protestave, demonstratave apo tubimeve tjera, nëse për këtë autorizohen nga zyrtarët kompetentë të Policisë.
5. Zyrtarët policorë mund ta angazhojnë qenin policor për kërkimin e substancave narkotike, të cilat mund të gjinden nëpër objekte, mjete transporti, valixhe dhe gjësende tjera.
6. Ekippet policore mund të angazhohen për gjetjen/zbulimin e mjeteve shpërthyesë dhe largimin e këtyre mjeteve.
7. Kur qentë policorë janë në dispozicion për gjurmim, atëherë ata mund të angazhohen për gjetjen e personave të humbur, personave të dyshimtë, gjetjen e kufomave ose për të gjetur ndonjë dëshmi, e cila në gjykatë mund të përdoret si dëshmi/provë.
8. Qeni policor nuk duhet të përdoret për shumim, pjesëmarrje nëpër shfaqje, në fusha të dyluftimit, në ekspozita apo demonstrime të tjera, përveç nëse një gjë e tillë autorizohet me shkrim nga Drejtori i Përgjithshëm apo i autorizuari i tij.
9. Zyrtari policor i cili është përgjegjës për qenin e policisë është i obliguar që të përkujdeset për qenin policor derisa është në kryerje të detyrës dhe jashtë detyrës.
10. Nëse zyrtari policor i cili është përgjegjës i qenit nuk mund të përkujdeset për qenin me të cilin është i ngarkuar për shkak të ndonjë sëmundje, lëndimi apo të ndonjë pushimi, atëherë caktohet një zyrtar policor/stërvitës tjetër, i cili përkohësisht do të përkujdeset për qenin policor ose qeni do të vendoset në ndonjë vend të caktuar nga autoriteti kompetent.

Neni 14 **Trafiku rrugor**

1. Zyrtarët policorë të trafikut rrugor kryejnë detyra të cilat nuk kufizohen vetëm në:
 - 1.1. Detyrat në zbatim të ligjeve të cilat kanë të bëjnë me trafik, angazhimin në trajtimin dhe hetimin e aksidenteve me lëndime të rënda apo me fatalitet, të shkaktuara nga automjetet motorike në zonat urbane, si dhe të gjitha aksidenteve tjera të shkaktuara jashtë zonave urbane;
 - 1.2. Të mbajë rendin dhe të kontrollojë trafikun e automjeteve brenda territorit të Kosovës, duke u bazuar në ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi të cilat kanë të bëjnë me trafikun rrugor.
2. Aksidentet e shkaktuara në trafikun urban mund të trajtohen nga stacionet policore, nëse njësitet e trafikut nuk janë në dispozicion.
3. Njësi i Trafikut operon në pajtueshmëri me ligjet dhe aktet që rregullojnë dhe aktet që e rregullojnë fushën e trafikut rrugor, udhëzuesin për mënyrën e kryerjes së detyrave në mbikëqyrjen dhe rregullimin e trafikut rrugor në të cilin përcaktohen rregullat, procedurat dhe udhëzimet për personelin e policisë, rregulloret, PSO, vendimet dhe aktet tjera të ngjashme.

4. Zyrtarët policorë patrullues të Stacionit, të cilët iu përgjigjen aksidenteve brenda zonave urbane, pasi që të arrijnë në vendin e ngjarjes dhe ta konstatojnë se është shkaktuar aksidenti me lëndime të rënda ose me fatalitet janë të obliguar që t'i kryejnë veprimet të cilat nuk kufizohen vetëm në:

- 4.1. Kontaktimin me Qendrën e Komunikimit, në mënyrë që përmes saj ta njoftojë Njësitin e Trafikut për aksidentin e shkaktuar;
- 4.2. Sigurimin e vendit të ngjarjes, përderisa të arrijë Njësiti i Trafikut;
- 4.3. Pas arritjes së Njësitet të Trafikut, policët e stacionit policor duhet të jenë në mbështetje të tyre për derisa rasti të përfundojë;
- 4.4. Nëse Njësiti i Trafikut nuk mund të jetë në dispozicion, atëherë me kërkesën e qendrës së komunikimit polici i stacionit policor duhet të merret me rast/aksident.

5. Njësiti i Trafikut merret me të gjitha aksidentet e trafikut të cilat rezultojnë me lëndime apo pasoja të rënda dhe me fatalitet, të cilat kanë ndodhur në territorin e Kosovës, përveç rasteve kur për shkaqe objektive nuk mund të jetë në dispozicion dhe të merren me këto raste.

6. Divizioni i Komunikacionit Rrugor është i obliguar që të mbajë informata statistikore lidhur me aksidentet dhe kundërvajtjet e shkaktuara në trafik, faktorët që kanë shkaktuar aksidente, si dhe të dhënat tjera të cilat janë të nevojshme.

Neni 15 **Patrullimi në zonën kufitare**

Departamenti i Policisë Kufitare, në kuadër të togjeve patrulluese, për mbikëqyrje të brezit kufitar përveç automjeteve policore për patrullim shfrytëzon edhe këto mjete motorike:

- a) Saja motorike;
- b) Barka patrulluese; dhe
- c) Motoçikleta me katër rrotë.

KAPITULLI III **RUAJTJA, BARTJA DHE PËRDORIMI I ARMËS ZYRTARE**

Neni 16 **Ruajtja e armës zyrtare**

1. Ruajtja dhe sigurimi i armës zyrtare është përgjegjësi e zyrtarit policor, të cilit i është dhënë arma. Zyrtarët policorë duhet të sigurohen se arma e tyre mirëmbahet dhe është në gjendje funksionale.

2. Zyrtari policor, derisa nuk është në detyrë, apo derisa nuk e bartë armën zyrtare është i obliguar që atë ta vendos në një vend të sigurt.

3. Nëse zyrtari policor udhëton jashtë shtetit dhe nuk ka mundësi që armën ta vendos në ndonjë vend të sigurt, atëherë atë mund ta dorëzojë për ruajtje në Zyrën për Shërbime Mbështetëse/Njësia për Përkrahjen e Personelit, e cila është në kuadër të stacionit policor apo në

ndonjë njësit tjetër në kuadër të Drejtorisë Rajonale apo Drejtorisë së Përgjithshme dhe duhet ta informoj mbikëqyrësin e drejtpërdrejt.

4. Zyrtari policor kur armën e dorëzon për ruajtje duhet të sigurohet se arma është e pastruar dhe në gjendje të rregullt, e pastaj të bëhet regjistrimi dhe deponimi i saj. Para dorëzimit arma vendoset në kutinë e armës për ruajtje, me ç'rast zyrtari i zyrës mbështetëse duhet ta kontrollojë armën dhe municionin i cili i dorëzohet për ruajtje, e pastaj e vendos atë në vend të sigurt.

5. Zyra për Shërbime Mbështetëse/Njësia për Përkrahjen e Personelit e cila e mban armën në ruajtje duhet të mbajë listën për armët të cilat ruhen, në përmbajtjen e të cilës duhet të shënohen të dhënat si në vijim:

- a) emrin e zyrtarit policor,
- b) numrin e KI-së të zyrtarit policor,
- c) numrin serik të armës,
- d) sasinë e municionit,
- e) datën e pranimit-dorëzimit (nënshkruar nga mbikëqyrësi i Zyrës për Shërbime Mbështetëse/ Njësia për Përkrahjen e Personelit dhe zyrtari policor).

6. Zyrtari policor me rastin e kthimit, apo para se ta fillojë punën është i obliguar që ta marrë armën nga Zyra për Shërbime Mbështetëse/Njësia për Përkrahjen e Personelit, me ç'rast duhet ta kontrollojë atë për t'u siguruar se a është arma dhe municioni në gjendjen në të cilën është dorëzuar.

Neni 17

Bartja e armës zyrtare

1. Secili zyrtar policor, pa marrë parasysh gradën, derisa është në kryerje të detyrës është i obliguar që ta bartë armën zyrtare, ndërsa kur nuk është në kryerje të detyrës ka të drejtë ta bartë armën zyrtare, mirëpo nuk është i obliguar.

2. Zyrtari policor gjatë bartjes së armës, është i obliguar që me veti ta bartë kartelën zyrtare identifikuese, si dhe të përkujdeset që të mbajë veshje adekuate në mënyrë që arma mos t'i shihet gjatë bartjes.

3. Zyrtari policor, derisa është në uniformë dhe në kryerje të detyrës, armën duhet ta bartë në këllëfin zyrtar, duke iu përmbajtur rregullave të bartjes së armës së zjarrit, të cilat përcaktohen me dispozita të kësaj rregulloreje dhe me aktet tjera të brendshme.

4. Zyrtarit policor, me akt të veçantë mund t'i merret përkohësisht arma zyrtare, dhe atë nëse:

- a) është i suspenduar;
- b) është i arrestuar;
- c) është nën ndikim të alkoolit dhe substancave psikotropike;
- d) përkohësisht i pezullohet marrëdhënia e punës në Polici;
- e) për shkaqe shëndetësore dhe psikike; dhe
- f) nëse dështon në trajnim dhe ricertifikim për përdorimin e armës.

5. Me dispozitat e Udhëzimit administrativ 03/2013 për përdorimin e armëve të zjarrit nga zyrtarët policorë, përcaktohen rregullat të cilat kanë të bëjnë me mbajtjen, bartjen dhe përdorimin e armëve të zjarrit nga zyrtarët policorë, si dhe rrethanat në të cilat atyre iu kufizohet përkohësisht e drejta e posedimit, bartjes dhe përdorimit të armës zyrtare.

Neni 18

Rregullat për bartjen e armës zyrtare

1. Zyrtari policor, i cili është në kryerje të detyrës dhe e bart armën zyrtare është i obliguar që t'u përmbahet rregullave dhe kufizimeve si në vijim:

1.1. Armën ta mbajë në gjendje të mbushur, në mënyrë që arma të jetë e gatshme për përdorim/zbrazeje.

1.2. Zyrtarët policorë armën e zbraztë mund ta mbajnë në rastet të cilat nuk kufizohen vetëm kur:

1.2.1. Janë në poligon të gjuajtjes;

1.2.2. Marrin pjesë në ushtrime apo trajnimin për gjuajtje me armë, dhe kur nga udhëheqësi apo mbikëqyrësi i trajnimit kërkohet një gjë e tillë;

1.2.3. Hyhet në objektet e disa institucioneve si: ndërtesën e gjykatës, burgut, apo ndonjë vend tjetër publik ku kërkohet që gjatë qëndrimit në ato objekte të gjitha armët të jenë të zbrazëta; dhe

1.2.4. Në rastet e nevojave specifike.

1.3. Në armën zyrtare duhet të vendoset vetëm municion i cili jepet nga Policia.

2. Armën zyrtare zyrtari policor nuk duhet ta nxjerrë, ta tregojë apo ta ekspozojë pa nevojë.

3. Gjatë bartjes së armës, zyrtari policor është i obliguar që të jetë i kujdesshëm, në mënyrë që t'i shmanget zbrazjes së rastësishme të saj, ndërsa nëse arma nuk bartet duhet gjithmonë të vendoset në vend të sigurt.

Neni 19

Kufizimet për përdorim apo gjuajtje me armë zyrtare

1. Nëse zyrtari policor e përdorë/zbrazë armën e zjarrit në vendet publike, atëherë ai duhet t'i ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme preventive, në mënyrë që kalimtarët e rastit mos të rrezikohen, si dhe dëmet dhe pasojat mundësisht të jenë sa më të vogla.

2. Zyrtari policor që është nën ndikimin e alkoolit apo substancave psikotropike nuk guxon të mbajë armë zyrtare.

3. Me rastin e përdorimit të armës me qëllim të konstatimit të gjendjes së saj, zyrtari policor fillimisht duhet të sigurohet se arma është e zbrazët, këtë mos ta bëjë në prezencën e personave tjerë dhe të jetë i kujdesshëm dhe të mos bëjë manovrime të panevojshme me armën e mbushur.

Neni 20

Raportimi mbi zbrazjen e armës

Zyrtari policor, i cili e përdorë/zbrazë armën e zjarrit derisa është në kryerje të detyrës është i obliguar që menjëherë (sa më shpejt që të jetë e mundur) ta lajmërojë mbikëqyrësin e tij të drejtpërdrejtë, ndërsa gjatë ndërrimit ta bëjë një raport me shkrim lidhur me përdorimin e armës së zjarrit. Pas këtyre veprimeve mbikëqyrësi obligohet ta plotësojë raportin/formularin mbi zbrazjen e armës, duke u bazuar në dispozitat nga neni 11 i Udhëzimit administrativ 03/2012 për përdorimin e armëve të zjarrit nga zyrtarët policorë.

Neni 21

Ruajtja dhe mirëmbajtja e armës zyrtare

1. Zyrtari policor duhet të përkujdeset që armën zyrtare ta mbajë dhe mirëmbajë në gjendje të rregullt. Zyrtarit policor, pa marrë parasysh a është në kryerje të detyrës apo jo është i obliguar që armën zyrtare ta mbajë të pastër dhe në gjendje të rregullt për përdorim.
2. Zyrtari policor nuk duhet armën e vet zyrtare t'ia japë apo t'ia dorëzojë askujt, përveç: instruktorit të gjuajtjes, instruktorit për armë, mbikëqyrësit apo komandantit të tij, apo ndonjë mbikëqyrësi apo eprori të nivelit më të lartë.
3. Në armën zyrtare nuk lejohet që të bëhet ndonjë ndryshim, përveç nëse me autorizim të instruktorit të gjuajtjes lejohet ndryshimi, i cili duhet të bëhet nga depoisti i armëve. Arma zyrtare në çdo kohë mund të inspektohet nga mbikëqyrësi apo instruktori i gjuajtjes.

KAPITULLI IV

ARRESTIMI, NDALIMIN POLICOR DHE KUFIZIMI I LËVIZJES SË LIRË

Neni 22

Arrestimi dhe ndalimi i personave

1. Policia e Kosovës, bazuar në autorizimet policore të përcaktuara me dispozitat e Ligjit për Policinë, Kodin e Procedurës Penale (në tekstin e mëtejme: KPP), Udhëzimin administrativ 01/2012 dhe aktet tjera normative në fuqi që e rregullojnë këtë çështje është autorizuar që të bëjë arrestimin dhe ndalimin e personave të dyshimtë.
2. Arrestimi dhe ndalimi i personave nga ana e zyrtarëve policorë bëhet vetë atëherë kur është e domosdoshme dhe atë, për aq sa është e nevojshme që të arrihen objektivat legjitime të Policisë, por jo më gjatë se gjashtë (6) orë, përveç në rastet e përcaktuara me ligj dhe akte tjera normative.
3. Arrestimi i përkohshëm dhe ndalimi i personave të miturit nga ana e policisë, bëhet në përputhje me dispozitat e KPP-së dhe Kodit të Drejtësisë për të Mitur.

Neni 23

Arrestimi dhe ndalimi i përkohshëm

1. Kur një person kapet në flagrancë deri sa është duke e kryer veprën penale, e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare ose është në ndjekje për veprën e kryer penale, policia është e autorizuar ta arrestojë atë përkohësisht edhe pa urdhër të gjykatës.

2. Pas arrestimit të personit të dyshimtë, sa më shpejt që është e mundur, por jo më vonë se gjashtë orë nga koha e arrestimit, prokurori publik personit të arrestuar ia lëshon vendim mbi ndalimin. Ky vendim duhet të përfshijë emrin dhe mbiemrin e personit të arrestuar, vendin, ditën dhe kohën e arrestimit, veprën penale për të cilën dyshohet, bazën juridike për arrestim dhe udhëzimin për të drejtën në ankesë.

Neni 24

Të drejtat e personit të arrestuar

1. Zyrtari policor me rastin e arrestimit dhe ndalimit është i obliguar që t'iu përmbahet dispozitave ligjore mbi të drejtat e personit të arrestuar të përcaktuara me dispozitat e KPP.

2. Personi i arrestuar gëzon këto të drejta:

2.1. Të drejtën që të informohet për arsyet e arrestimit në gjuhën të cilën ai/ajo e kupton;

2.2. Të drejtën për të heshtur dhe mos ti përgjigjet asnjë pyetjeje, përveç obligimit për dhënien e të dhënave/shënimeve mbi identitetin e tij/saj;

2.3. Të drejtën për ti ofrohet përkthimi pa pagesë, nëse nuk mund ta kuptojë ose ta flasë gjuhën e organeve legjitime;

2.4. T'i ofrohet ndihma e mbrojtjes sipas zgjidhjes së tij/saj. Nëse i arrestuar nuk ka mundësi që të angazhoj mbrojtës dhe askush nuk angazhon mbrojtës për të, atëherë atij i caktohet mbrojtësi me shpenzime publike.

2.5. T'i njoftojë ose të kërkojë nga organet e zbatimit të ligjit që ta njoftojnë familjen e personit të arrestuar, apo ndonjë person tjetër të caktuar sipas zgjedhjes së tij për arrestimin;

2.6. Të ketë kontroll dhe trajtim mjekësor, duke përfshirë edhe trajtimin psikiatrik;

2.7. Nëse i arrestuari është shtetas i huaj, përveç të drejtave që i takojnë çdo të arrestuari ai/ajo ka edhe këto të drejta: të komunikojë me gojë ose me shkrim, përmes zyrës së ndërlidhjes, postës konsullore, misionit diplomatik të shtetit qytetar i të cilit është ai/ajo, apo me përfaqësuesin e organizatës kompetente ndërkombëtare, nëse është refugjatë ose nën mbrojtjen e ndonjë organizate ndërqeveritare;

3. Personi i arrestuar veçohet nga personat e dënuar ose nga personat e paraburgosur.

4. Personat e arrestuar apo ndaluar të gjinive të ndryshme nuk mbahen në të njëjtën dhomë.

5. Personit të ndaluar për më shumë se dymbëdhjetë (12) orë i sigurohen tri racione ushqimi brenda ditës.

6. Brenda njëzet e katër (24) orëve, personi i arrestuar ka të drejtë në së paku tetë (8) orë pushim pa ndërprerje. Gjatë kohe së pushimit personi i arrestuar nuk merret në pyetje e as nuk trazohet nga policia lidhur me hetimin.

Neni 25

Njoftimi për arrestimin

1. Personi i arrestuar ka të drejtë që menjëherë pas arrestimit të lajmërojë ose të kërkojë nga policia që të lajmërojnë anëtarin e familjes ose ndonjë person tjetër sipas zgjedhjes së tij për arrestimin dhe vendin e ndalimit, si dhe për çdo ndryshim të mëvonshëm të vendit të ndalimit, menjëherë pas ndryshimit të tillë.
2. Kur personi i arrestuar nuk e ka mbushur moshën tetëmbëdhjetë (18) vjet, policia menjëherë pas arrestimit e lajmëron prindin ose përfaqësuesin ligjor të personit të arrestuar për arrestimin dhe vendin e ndalimit dhe për çdo ndryshim të mëvonshëm të vendit të ndalimit.
3. Kur lajmërimi për arrestim nga paragrafi 1 dhe 2 i këtij neni është i pamundur ose do të ishte i dëmshëm për personin e arrestuar, apo i arrestuari shprehimisht refuzohet, policia e lajmëron Qendrën për punë sociale.
4. Lajmërimi i anëtarëve të familjes dhe i personave të tjerë përkatës për arrestimin e personit të dyshimtë mund të vonohet më së shumti deri në njëzet e katër (24) orë, nëse prokurori i shtetit çmon se kjo kushtëzohet me nevoja të jashtëzakonshme për hetimin e rastit. Vonesë të tillë nuk vlejnë për personin e arrestuar i cili është nën moshën tetëmbëdhjetë (18) vjet, ose i cili tregon shenja të çrregullimit apo të paaftësisë mendore.

Neni 26

Të drejtat e personit të arrestuar gjatë marrjes në pyetje

1. Gjatë marrjes në pyetje nga policia, personi i arrestuar ka të drejtë në praninë e mbrojtësit të tij. Nëse mbrojtësi nuk paraqitet brenda dy (2) orëve pas informimit për arrestimin, Policia i cakton mbrojtës tjetër. Nëse, pas informimit nga policia edhe mbrojtësi tjetër nuk paraqitet brenda një ore, personi i arrestuar mund të merret në pyetje vetëm nëse prokurori i shtetit ose policia çmon se shtyrja e mëtejshme do të rrezikonte seriozisht zbatimin e hetimeve.
2. Me rastin e marrjes në pyetje të personit të arrestuar përshtatshmërisht zbatohen nenet 152 deri 155 të KPP.
3. Gjatë marrjes në pyetje të personit të arrestuar duhet të bëhen pushime të shkurtra në interval kohor prej dy (2) orësh. Pushimi mund të shtyhet kur ka shkaqe të arsyeshme për të besuar se shtyrja do të:
 - 3.1. shkaktonte rrezik për lëndim të personave, humbje apo dëmtim të rëndë të pasurisë;
 - 3.2. shtynte pa nevojë ndalimin e personit ose përfundimin e marrjes në pyetje; ose
 - 3.3. prejdhikonte rezultatin e hetimeve.
4. Gjatë marrjes në pyetje nuk kërkohet nga personi i arrestuar që të qëndrojë në këmbë, si dhe nuk i mohohet ushqimi, uji dhe kujdesi i nevojshëm mjekësor.
5. Procesverbalet mbi arrestimin ruhen në polici dhjetë (10) vjet, nga koha e përfundimit zyrtar të procedurës penale ose nga lirimi i personit të ndaluar.

Neni 27

Procesverbali i arrestimit

1. Policia mban një procesverbal të vetëm për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me personin e arrestuar, duke përfshirë:
 - 1.1. të dhënat personale të të arrestuarit;
 - 1.2. arsyet e arrestimit;
 - 1.3. veprën penale për të cilën dyshohet;
 - 1.4. autorizimin ose njoftimin e prokurorit të shtetit;
 - 1.5. vendin, datën dhe kohën e saktë të arrestimit;
 - 1.6. rrethanat e arrestimit;
 - 1.7. çfarëdo vendimi të prokurorit të shtetit lidhur me ndalimin;
 - 1.8. vendin e ndalimit;
 - 1.9. identitetet përkatëse të zyrtarëve të policisë dhe të prokurorit të shtetit;
 - 1.10. njoftimin gojor dhe me shkrim të personit të arrestuar mbi të drejtat e tij të parapara në nenin 164, paragrafi 4. dhe nenin 167 të KPP-së;
 - 1.11. informimin mbi ushtrimin e të drejtave të parapara në nën-paragrafin 1.10. të këtij paragrafi nga personi i arrestuar, veçanërisht e drejta në mbrojtës dhe e drejta për t'i lajmëruar anëtarët e familjes ose personat tjerë përkatës;
 - 1.12. lëndimet e dukshme apo shenjat tjera që shtrojnë nevojën për ndihmë mjekësore;
 - 1.13. ndërmarrjen e një ekzaminimi mjekësor ose sigurimin e trajtimit mjekësor;
 - 1.14. informacionin mbi kontrollin e përkohshëm dhe përshkrimin e sendeve të marra nga personi në kohën e arrestimit ose gjatë ndalimit;
 - 1.15. daljen e personit të arrestuar nga objekti, përfshirë kohën dhe datën e saktë, nëse personi është liruar apo është dërguar në gjykatë, apo nëse është transferuar në qendrën e paraburgimit.

2. Policia mban procesverbal për çdo seancë të marrjes në pyetje të personit të arrestuar, duke përfshirë kohën e fillimit dhe të përfundimit të marrjes në pyetje, identitetin e zyrtarit të policisë i cili e ka marrë në pyetje dhe personat tjerë të pranishëm. Nëse mbrojtësi i personit të arrestuar nuk ka qenë i pranishëm me rastin e marrjes në pyetje, është obligative që të evidentohet në procesverbal.

3. Procesverbalet nga paragrafi 1. i këtij neni nënshkruhen nga zyrtari përkatës i policisë dhe nga personi i arrestuar. Kur personi i arrestuar refuzon nënshkrimin e procesverbalit, zyrtari kompetent e shënon refuzimin e tillë, duke i cek arsyet e refuzimit ose komentet eventuale të personit të arrestuar të bëra me shkrim ose me gojë.

4. Procesverbalet nga paragrafët paraprak të këtij neni i vihen në dispozicion personit të arrestuar dhe mbrojtësit të tij, nëse këta e kërkojnë.

Neni 28

Arrestimi i përkohshëm dhe ndalimi policor i personave të miturve

1. Arrestimi i përkohshëm dhe ndalimi policor i të miturit urdhërohet vetëm si masë e fundit dhe atë për një kohë sa më të shkurtër të mundshme.

2. Arrestimi i përkohshëm dhe ndalimi i personave të miturit nga ana e policisë, bëhet në përputhje me dispozitat e nenit 162, 163 dhe 164 të KPP-së dhe dispozitat e Kodit të Drejtësisë për të Mitur.
3. Arresti i përkohshëm apo ndalimi i të miturit nuk mund të kalojë periudhën njëzetekatër (24) orësh. Pas kalimit të kësaj periudhe, policia e liron të miturin, përveç nëse gjyqtari për të mitur cakton paraburgim.
4. Gjyqtari për të mitur mund të caktojë paraburgimin ndaj të miturit nëse ekzistojnë arsyet e përcaktuara me dispozitat e KPP të Kosovës dhe nëse alternativat tjera nuk do të ishin të mjaftueshme për të siguruar praninë e të miturit, për të parandaluar kryerjen e serishme të veprës dhe për të siguruar zbatim të suksesshëm të procedurës. Gjyqtari për të mitur shqyrton nëse masat e parapara në nenin 6 të Kodit të Drejtësisë për të Mitur ose në nenin 173 të KPP-së të mund të urdhërohen si alternativë për paraburgimin. Aktvendimi mbi paraburgimin e të miturit përfshin një shpjegim të arsyetuar domosdoshmërinë e paraburgimit dhe pamjaftueshmërinë e shqiptimit të ndonjë mase tjetër alternative.
5. I mituri mund të mbahet në paraburgim me aktvendim të gjyqtarit për të mitur për një periudhë maksimale prej tridhjetë (30) ditësh nga dita kur ai është arrestuar. Paraburgimi i të miturit mund të vazhdohet vetëm nga kolegji për të mitur i gjykatës kompetente për një periudhë shtesë deri në gjashtëdhjetë (60) ditë.
6. I mituri nuk mund të mbahet në paraburgim më shumë se dymbëdhjetë (12) muaj nga dita e arrestit.
7. Kolegji për të mitur i gjykatës kompetente e rishqyrton aktvendimin për paraburgim brenda tridhjetë (30) ditëve nga marrja e aktvendimit. Rishqyrtimi i tillë bëhet në seancë dëgjimore në praninë e të miturit, mbrojtësit të tij dhe prokurorit.
8. Të miturit që mbahen në paraburgim në qendrën e paraburgimit ndahen nga të paraburgosurit madhorë.
9. I mituri i cili mbahet në paraburgim mund të mbahet në institucionin edukativo korrektues, nëse gjyqtari për të mitur konsideron se kjo është në interesin më të mirë të miturit.
10. Derisa i mituri mbahet në paraburgim, atij sipas nevojës dhe në përputhje me moshën, gjininë dhe personalitetin e tij, i ofrohet ndihmë sociale, edukative, psikologjike, mjekësore dhe fizike.
11. Autorizimet e gjyqtarit për të mitur, lidhur me të miturin në paraburgim janë të njëjta sikurse autorizimet e gjyqtarit të procedurës paraprake lidhur me të rriturit në paraburgim, të cilat janë të përcaktuara me dispozitat e KPP-së.

Neni 29

Evidentimi i arrestimit dhe i intervistës nga ana e policisë

1. Policia mban evidencë të rregullt për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me personin e arrestuar, duke përfshirë:
 - 1.1. Të dhënat personale të arrestuarit;
 - 1.2. Arsyen e arrestimit;
 - 1.3. Veprën penale për të cilën dyshohet;
 - 1.4. Autorizimin ose njoftimin e prokurorit të shtetit;
 - 1.5. Vendin, datën dhe kohën e saktë të arrestimit;
 - 1.6. Rrethanat e arrestimit;
 - 1.7. Çfarëdo vendimi të prokurorit të shtetit;
 - 1.8. Vendin e ndalimit;
 - 1.9. Identitetin e zyrtarit policor dhe të prokurorit të shtetit;
 - 1.10. Informimin mbi ushtrimin e të drejtave të parapara në këtë rregullore, veçanërisht e drejta në mbrojtës dhe e drejta për t'i lajmëruar anëtarët e familjes ose personat tjerë përkatës;
 - 1.11. Lëndimet e dukshme apo shenjat tjera që shtrajnë nevojën për ndihmë mjekësore;
 - 1.12. Ndërmarrjen e një ekzaminimi mjekësor ose sigurimin e trajtimit mjekësor; dhe
 - 1.13. Informacionin mbi kontrollin e përkohshëm të sigurisë së personit dhe përshkrimin e sendeve të marra nga personi në kohën e arrestimit ose gjatë ndalimit.
2. Policia mban shënimet me shkrim dhe mund të bëjë regjistrimin auditiv dhe vizual për çdo intervistë të bërë me personin e arrestuar, përfshirë shënimet për kohën e fillimit dhe të mbarimit të çdo interviste me personin e arrestuar, identitetin e policëve që e kanë zhvilluar intervistën si dhe të gjithë personat prezentë gjatë intervistës. Nëse avokati mbrojtës nuk është prezent, kjo duhet të evidentohet në mënyrën e duhur, dhe të ceket arsyeja e mungesës së tij.
3. Shënimet me shkrim dhe regjistrimet auditive ose vizuale të përshkruara në paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni i vihen në dispozicion personit të arrestuar dhe mbrojtësit të tij/saj nëse ata i kërkojnë, si dhe organeve të zbatimit të ligjit dhe prokurorit.

Neni 30

Kufizimi i përkohshëm i lirisë së lëvizjes

Zyrtari policor është i autorizuar që përkohësisht t'ia kufizojë lirinë e lëvizjes personit në një zonë të caktuar ose ta orientojë lëvizjen e tij në një zonë tjetër.

Neni 31

Kontrollimi i personave

1. Gjatë ndalimit policor ose arrestimit, zyrtari policor është i obliguar që të bëjë kontrollin fizik të personit të ndaluar ose të arrestuar, duke u bazuar në aktet normative në fuqi.
2. Zyrtari policor i cili e bën arrestimin e ndonjë personi është përgjegjës për transportim të sigurt të personit të arrestuar deri te vendi i paraburgimit.
3. Personit të arrestuar duhet t'i vihen prangat në pajtim me dispozitat e kësaj rregulloreje.

Neni 32

Vënia e prangave dhe përdorimi i mjeteve siguroese

1. Zyrtarët e Policisë janë të obliguar që të gjithë të arrestuarve, ndaluarve, paraburgosurve dhe të burgosurve t'ua vejnë prangat (dy herë të kyçura) me duar prapa shpine dhe me pëllëmbë që kanë shikimin/pamjen përjashta.
2. Zyrtarët e Policisë mund t'ia vejnë prangat me duar përpara, apo të përdorin mjete tjera të sigurimit të aprovuara në rastet kur kemi të bëjmë me:
 - 2.1. gruan shtatzënë;
 - 2.2. personin e moshuar;
 - 2.3. personin i cili ka ndonjë lëndim që mund t'ia keqësonte gjendjen me rastin e prangosjes.
3. Procedura e prangosjes për femra është e njëjtë sikur për meshkujt.
4. Zyrtarët policor në bazë të vendimit të tyre personal vendosin kur e prangosin të miturin. Të miturit i cili është problematik apo që ka gjasa të jenë të dhunshëm duhet ti vendosen prangat apo ndonjë mjete tjetër të sigurisë i cili është i përshtatshëm dhe i aprovuar për përdorim.
5. Të arrestuarit, ndaluarit, paraburgosurit apo të burgosurit gjatë transportit nuk duhet të jenë të lidhur me pranga për ndonjë pjesë të automjetit transportues.
6. Prangat e këmbëve dhe mjetet tjera shtesë të sigurimit shtesë të sigurimit të cilat janë të aprovuara , mund të përdoren nga zyrtarët policor nëse personi i cili transportohet reziston me dhunë ndaj arrestit, është agresiv dhe i dhunshëm, i cili paraqet kërcënim për veten, për zyrtarë policorë apo të tjerët.

Neni 33

Veprimet për siguri

1. Para transportimit, të gjithë personat duhet të kontrollohen në tërësi, për tu siguruar se nuk posedojnë ndonjë armë apo mjete tjera.
2. Kontrollimet duhet të bëhen nga zyrtari policor i gjinisë së njëjtë.
3. Zyrtari policor i cili bën transportin duhet ta kontrollojë personin i cili transportohet, pavarësisht nga kontrollimet e mëparshme që i janë bërë atij.
4. Të arrestuarit, ndaluarit, paraburgosurit apo të burgosurit e gjinisë femërore, kur kjo është e mundshme, duhet të shoqërohen nga zyrtaret femra.
5. Transportimi i të arrestuarve të mitur nuk të bëhet me të njëjtin automjet, ku gjenden edhe personat e rritur.

6. Me rastin e transportit të personave të rrezikshëm duhet të ndërmerren masa speciale të sigurisë shtesë.

Neni 34

Veprimet policore gjatë transportimit

1. Zyrtarët policorë gjatë transportit të personave të arrestuar, ndaluar, paraburgosur apo burgosur transportohen janë të obliguar që në vazhdimësi ti kenë nën mbikëqyrje dhe kontroll këta persona.
2. Gjatë transportit të personave nga paragrafi paraprak, mënyra e të ulurit në automjetin policor, duhet të jetë si në vijim:
 - 2.1. Nëse automjeti policor posedon rrjetin e metaltë mbrojtës, personi që transportohet duhet të shoqërohet nga dy zyrtarë policorë, cilët duhet të jenë në anën e djathtë të ulëses së pasme.
 - 2.2. Kur i arrestuari, bartet në një automjet që nuk e ka rrjetin e metaltë mbrojtës dhe shoqërohet nga dy zyrtarë policorë, personi i cili transportohet duhet të vendoset në anën e djathtë të pjesës së pasme, ndërsa zyrtari i dytë duhet të ulet në anën e majtë të pjesës së pasme (pas shoferit).
 - 2.3. Masa të aprovuara të sigurimit shtesë mund të përdoren atëherë kur zyrtari policor beson se personi i cili transportohet mund të ketë sjellje të dhunshme.
 - 2.4. Personat të cilët transportohen duhet të vendosen në automjet në mënyrë të sigurt, duke përdorur rripat e sigurisë.

KAPITULLI V

TRAJTIMI I PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR DHE I FËMIJËVE

Neni 35

Personat me aftësi të kufizuar

1. Bazuar në dispozita e Konventës mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara të Kombeve të Bashkuara, personat me aftësi të kufizuar janë personat që kanë dëmtime afatgjata fizike, mendore, intelektuale ose shqisore, të cilët në bashkëveprim me pengesa të ndryshme mund ta pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë, efektive dhe të barabartë me të tjerët në shoqëri.
2. Personat me aftësi të kufizuara janë kategori shumë e ndjeshme e personave, të cilët kanë nevojë për ndihmë, përkrahje, mbroje, udhëzime dhe përkujdesje të veçantë nga Policia dhe nga të gjitha institucionet tjera.
3. Zyrtari policor me rastin e marrjes me rastin, i cili ka të bëjë me personin me aftësi të kufizuar duhet të ketë sa më shumë informata për te, familjen, shokët dhe mjedisin ku ai jeton, pastaj informat lidhur rastin, ngjarjen dhe pasojat që kanë ndodhë, e të cilat mund ta shqetësojnë dhe e bëjnë atë agresiv dhe të dhunshëm personin me aftësi të kufizuar.

Neni 36

Obligimet zyrtarit policor ndaj personave me aftësi të kufizuar

Zyrtarët policorë, në raport me personat me aftësi të kufizuar, janë përgjegjës që t'i koordinojnë veprimet specifike që dalin nga aktet vendore dhe ndërkombëtare që e rregullojnë trajtimin e këtyre personave, që të sigurohen që të drejtat e këtyre personave janë duke u respektuar, dhe se ndaj tyre nuk është duke u bërë kurrfarë padrejtësie apo diskriminimi, pavarësisht se këta persona a janë në cilësinë e dëshmitarit, viktimës, dëmtuarit apo të dyshuarit.

Neni 37

Arrestimi dhe ndalimi i personave me aftësi të kufizuar

1. Bazuar në Ligjin, KPP dhe akteve tjera normative që e rregullojnë këtë çështje, personat me aftësi të kufizuar, mund të arrestohen dhe ndalohen nga zyrtari policor.
2. Kur personi i arrestuar tregon shenja të çrregullimit mendor ose të paaftësisë mendore, policia menjëherë pas arrestimit njofton personin e caktuar nga personi i arrestuar dhe Qendrën për punë sociale për arrestimin dhe vendin e ndalimit, si dhe për çdo ndryshim të mëvonshëm të vendit të ndalimit.
3. Me kërkesën e personit të arrestuar, familjes së tij, apo kur policia konsideron se kjo është e nevojshme, të arrestuarit i ofrohet trajtim mjekësor, përfshirë edhe trajtimin psikiatrik.
4. Çdo herë kur personi i arrestuar tregon shenja të sëmundjes mentale, zyrtari policia është e obliguar që menjëherë të kërkoj kontrollin mjekësor të tij nga ndonjë psikiatër.
5. Çdo trajtim mjekësor dhe rezultati i kontrollit mjekësor për personat me aftësi të kufizuar duhet të evidentohet/regjistrohet dhe se shënimet e tilla i vihen në dispozicion personit të arrestuar dhe mbrojtësit të tij.

Neni 38

Personat me çrregullime mendore

1. Personat me çrregullime mendore janë ajo kategori e personave, te të cilët shfaqen shenjat e paaftësisë për të menduarit racional, për ta majtë veten në kontroll, shqetësimi dhe frikësimi i paarsyeshëm, agresiviteti, tentimi për të bërë vrasje apo vetëvrasje, si dhe veprime tjera të ngjashme.
2. Simptomat apo shenjat të cilat paraqiten te personat çrregullime mendore janë:
 - 2.1. Problemet apo vështirësitë në të menduar, humbja e memories lidhur me ngjarjet, faktet apo të dhënat e rëndomta si: të dhënat mbi identitetin e tij, adresën e vendbanimit, si dhe veprime tjera të ngjashme;
 - 2.2. Krijimi i bindjes së gabueshme apo paragjyqimeve që ndërlihet me gjendjen shëndetësore, shpirtërore etj, për veten apo persona të caktuar;
 - 2.3. Shqetësimet dhe humbja e stabilitetit kur shfaq ngjarje, incidente, persona apo gjëra të caktuara;
 - 2.4. Shqetësimet kur dëgjon zëra urdhërues/komandues si dhe zhurmë dhe tinguj të ndryshëm;

2.5. Shfaqja e frikës, emocioneve dhe depresionit në përmasa të mëdha.

Neni 39

Trajtimi i Personave me çrregullime mendore

1. Zyrtarët policorë, çdo herë kur merret me rastet të cilat kanë të bëjnë me personat me çrregullime mendore duhet të jetë i kujdesshëm dhe gjithmonë t'i trajtoj me prioritet dhe humanitet . Gjatë trajtimit dhe intervistimit të tyre duhet ta ketë parasysh se këta mund të jenë agresiv dhe të kryejnë veprime të pakontrolluara dhe të dhunshme, të cilat mund të jenë të rrezikshme për te dhe të tjerët.

2. Zyrtari policor me rastin e marrjes me rastet të cilat kanë të bëjnë me personat nga paragrafi paraprak është i obliguar që ti ndërmer veprimet në vijim:

2.1. Gjatë shkuarjes në vendin e ngjarjes, mundësisht mos përdoren dritat emergjente dhe sirenat;

2.2. Të mblidhen sa ma shumë informata lidhur me rastin, personat e përfshirë në rast dhe pasojat, në mënyrë që pastaj të ndërmerren veprimet e duhura që situata të jetë nën kontroll. Në këto raste, nëse zyrtari policor vlerëson se është e nevojshme të kërkohet ndihmë profesionale për të asistuar me rastin e komunikimit dhe intervistimit të personit me çrregullime mendore;

2.3. Gjatë kontaktit dhe komunikimit me personin me çrregullime mendore zyrtarit policor duhet të jenë i përmbajtur, qeta dhe jo kërcënuese, në mënyrë që personi i sëmurë mos të frikësohet prej tij, por ta fitoj bindjen se policia është aty për ta ndihmuar atë e jo për ta frikësuar;

2.4. Me rastin e arrestimit apo intervistimit të personave nga paragrafi 1 i këtij neni, përveç zyrtarit policor i cili merret me rast, në ndihmë të tij mundësisht të jetë së paku edhe një zyrtar policor;

2.5. Gjatë intervistimit të personit nga paragrafi paraprak, zyrtari policor duhet të jetë i sinqertë, në mënyrë që ta fitoj besimin e plotë te personi i sëmurë. Polici duhet t'ia mundësoj ati që ai ti shpreh lirshëm problemet, shqetësimet dhe ndjenjat e veta, në mënyrë që pastaj të vendoset për veprimet e mëtejme të cilat duhet të ndërmerren për zgjidhjen më të mirë të mundshme të problemit.

Neni 40

Përcaktimi i rrezikut

1. Personat me çrregullime mendore nuk konsiderohen persona të rrezikshëm, mirëpo nuk përjashtohet mundësia që në rrethana dhe kushte të caktuara disa nga këta persona të jenë të rrezikshëm për veten dhe të tjerët.

2. Shenjat apo indikacionet të cilat zyrtari policor duhet t'i merr parasysh se personi me çrregullime mendore është agresiv dhe i rrezikshëm janë:

2.1. Informatat nga ndonjë anëtar i familjes, fqiu apo shokut të personit me çrregullime mendore, se i njëjti reflekton dhunën në rrethana të caktuara.

2.2. Dyshimi se personi me çrregullime mendore ka në posedim armë apo ndonjë send tjetër të rrezikshëm të cilën mund ta përdor;

2.3. Informata, apo deklaratat e dhëna në Polici, se personi me çrregullime mendore është duke kryer, apo pritet që të kryej ndonjë sulm apo veprim të dhunshëm, i cili mund të jetë i rrezikshëm;

2.4. Mundësia e përsëritjes së veprimit të dhunshëm, të cilin veprim ma herët ka dështuar që ta kryej;

2.5. Sjelljet dhe veprimet e pakontrolluara të personit me çrregullime mendore, frikësimi, ngritja e emocioneve, zemërimi i paarsyeshëm, premtimet e rrejshme, deklarimi se tani është mirë dhe e ka vetën nën kontroll etj.

Neni 41

Përkujdesje dhe rekomandimi për trajtim të mëtejshëm

1. Bazuar në gjendjen aktuale të personit me çrregullime mendore, rrethanat e përgjithshme dhe gjykimin e shëndosh për një dhunë të mundshme zyrtari policor, personit me aftësi të kufizuar dhe familjes së tij mund ti rekomandoj trajtimin e tij në ndonjë qendër të strehimit shëndetësor, ose i njëjti të mbahet nën përkujdesje, për deri sa të arrijn shërbimi emergjent ta dërguar atë në ndonjë qendër spitalore.

2. Zyrtari policor, për shkak të sigurisë, apo për arsye tjera të përcaktuar me dispozita ligjore, personin me çrregullime mendore nuk duhet ta bartë/transportoj për përkujdesje në qendrat spitalore.

3. Personi me çrregullime mendore, i cili mund të jetë i rrezikshëm, përkundër dëshirës së tij duhet të merret në përkujdesje, në mënyrë që mos të vije deri te ndonjë veprim i dhunshëm dhe me pasoja, mirëpo në këto raste zyrtari policor paraprakisht duhet ta informoj mbikëqyrësin e tij ose zyrtarin përgjegjës, dhe sa ma shpejt që të jetë e mundshme të thirret mjeku përkatës për ofrimin e ndihmës dhe përkujdesjes së nevojshme në qendrën spitalore përkatës.

4. Bartja/transporti i personit i cili është në përkujdesje, duhet të bëhet sa ma shpejt që të jetë e mundur, sepse zhegitjet mund ta bëjnë atë agresivë dhe të dhunshëm. Gjatë transportit duhet përkujdesur që i sëmurë mos të ketë kontakt me armë apo pajisje tjera të rrezikshme, me të cilat mund ta lëndoj vetën apo të tjerët.

5. Zyrtari policor i cili merret me rastin i cili ka të bëjë me personat me çrregullime mendore është i obliguar që sa ma parë që të jetë e mundur të përpiloj raportin me shkrim, në të cilin shkurtimisht duhet të cekën rrethanat e incidentit, sjelljet e personit të sëmurë, pasojat e shkaktuara dhe veprimet policore të cilat janë ndërmarr lidhur me atë rast.

Neni 42

Trajtimi i fëmijëve në procedurën policore

1. Sistemi i drejtësisë për të mitur synon mirëqenien e të miturit dhe siguron që çdo reagim ndaj kryerësve të mitur të jetë gjithmonë në proporcion me rrethanat e kryerësit dhe veprës penale.

2. Fëmijës që merr pjesë në procedurë penale i ofrohet mundësia që të shprehet lirisht.

3. Çdo i mitur i privuar lirie trajtohet me humanizëm për hir të dinjitetit të personalitetit të tij njerëzor, dhe me atë rast merren parasysh nevojat personale të moshës së tij. Në veçanti, çdo i mitur i privuar lirie ndahet nga madhorët, përpos nëse konsiderohet se është në interes të miturit që ai mos ndahet, dhe gëzojnë të drejtën e mbajtjes së kontakteve me familjen e tij përmes korrespondencave dhe vizitave, përveç rrethanave të jashtëzakonshme të përcaktuara me ligj.

4. Çdo i mitur i privuar lirie ka të drejtë në ndihmë të menjëhershme ligjore dhe ndihmë tjetër adekuate, si dhe të drejtën për të kundërshtuar ligjshmërinë e privimit të tij nga liria pranë një gjykate të pavarur dhe të paanshme, si dhe në procedurë të menjëhershme.

5. Për t'iu shmangur lëndimit për shkak të publicitetit të tepruar ose etiketimeve, e drejta e fëmijës për privatësi respektohet në të gjitha fazat. Në parim, nuk publikohet asnjë informacion që shpie në identifikimin e kryerësit të mitur.

Neni 43 **Detyrat e zyrtarit policor**

Policia, në raport me këtë kategori të personave, përveç që kanë përgjegjësi t'i koordinojnë dhe t'i bashkërendojnë të gjitha veprimet specifike që dalin nga Kodi i Drejtësisë për të Mitur dhe ligjet tjera në fuqi, duhet gjithashtu të sigurojnë që të gjitha të drejtat që iu përkasin miturve janë duke u zbatuar dhe respektuar.

Neni 44 **Detyrat në rast të ndalimit policor**

Bazuar në Ligjin për Policinë dhe në aktet nënligjore, e veçanërisht në Kodin e Drejtësisë për të Mitur, edhe personat e mitur, mund të ndalohen nga policia, por nuk mund të kaloj periudhën njëzetekatër (24) orësh.

Neni 45 **Intervista me fëmijë**

1. Zyrtari policor që merret me rastin duhet të veprojë në përputhje me procedurat vijuese:
 - 1.1. Interesit të fëmijës duhet t'i kushtohet rëndësi të veçantë si dhe sigurimi i përkujdesjes mjekësore ndaj fëmijës është prioriteti i parë në të gjitha rastet.
 - 1.2. Në asnjë rast fëmija nuk do të merret në pyetje pa qenë të pranishëm prindërit, prindërit adoptues ose kujdestari (në qoftë se prindërit nuk janë të dyshuar për ndonjë veprim kundërligjor ndaj fëmijës). Megjithatë, zyrtari policor mund ta intervistojë fëmijën në qoftë se vonesa e shkaktuar do t'i rrezikonte seriozisht hetimet. Zyrtari policor duhet ta bëjë arsyetimin me shkrim për intervistimin e fëmijës pa prezencën e njërit nga personat e shënuar më lart. Vetëm zyrtarët policorë të trajnuar për këtë lëmi e kryejnë intervistimin e fëmijës.
 - 1.3. Gjatë marrjes në pyetje personat që marrin pjesë, janë të obliguar që të veprojnë me kujdes, duke marrë parasysh zhvillimin psikologjik, ndjeshmërinë dhe karakteristikat personale të fëmijës, në mënyrë që marrja në pyetje të mos merr ndikim të kundërt gjatë zhvillimit të saj. Kujdes të posaçëm duhet t'u kushtohet fëmijëve nën moshën katërmbëdhjetëvjeçare.

1.4. Intervistimi i fëmijës duhet të bëhet në gjuhën e tij. Përkthimi duhet të bëhet fjalë për fjalë, pa përmbledhje, posaçërisht nëse intervista nuk është duke u incizuar.

1.5. Policët do t'i japin fëmijës pushime të kohëpaskohshme, sipas nevojës, dhe do ta ndalin intervistën në qoftë se vërehet se fëmija po lodhet, pasi që kjo mund të shpie në deklarata të gabuara.

1.6. Në fund të intervistës fëmijës duhet t'i lejohej të bëjë pyetje apo të shpjegojë gjërat që i kujtohen atij/asaj pas marrjes në pyetje.

Neni 46 Trajnimi

1. Të gjithë zyrtarët policorë, të cilët merren me delikuençën e të miturve, duhet të jenë të trajnuar për intervistimin e të miturve.

2. Të gjithë zyrtarët policorë udhëzohen që të kenë njohuri të hollësishme rreth autorizimeve dhe procedurave që i ndërmarrin për viktimat fëmijë.

3. Policia e Kosovës ka për detyrë ofrimin dhe trajnimin e plotë për autorizimet dhe procedurat që kanë të bëjnë me viktimat fëmijë.

KAPITULLI VI DREJTORIA PËR SIGURIMIN E OBJEKTEVE ME RËNDËSI TË VEÇANTË DHE TË PERSONALITETEVE

Neni 47

Drejtoria për Sigurimin e Objekteve me Rëndësi të Veçantë dhe të Personaliteteve

Drejtorisë për Sigurimin e Objekteve me Rëndësi të Veçantë dhe të Personaliteteve (në tekstin e mëtejshëm: DSORVP) është përgjegjëse për sigurimin fizik të ndërtesave/objekteve me rëndësi të veçantë si: objektet qeveritare, objektet e rezidencave, përfaqësive diplomatike, ndërtesat dhe objektet përcjellëse të Policisë, objektet e trashëgimisë kulturore e fetare, sigurimin fizik të personaliteteve të larta vendore, ndërkombëtare, të delegacioneve të huaja, me rastin e vizitave zyrtare në Kosovë, bën ekstradimin e personave dhe në raste të caktuara e bën edhe përcjelljen e dëshmitareve të mbrojtur.

Neni 48

Kompetencat e DSORVP-së

1. DSORVP-ja, është përgjegjëse për sigurimin dhe mbrojtjen e objekteve me rëndësi të veçantë, personaliteteve të ndryshme, delegacioneve të caktuara, si dhe detyra tjera të cilat janë në kuadër të fushë veprimtarisë së kësaj Drejtorie.

2. Sigurimi i objekteve, personaliteteve dhe punë tjera të cilat kanë të bëjnë me siguri, e të cilat i kryen DSORVP bëhet mbi bazën e vlerësimit të sigurisë nga njësitet kompetente të Policisë, duke u bazuar në vendimet e Qeverisë dhe marrëveshjeve të mirëkuptimit.

3. Sigurimi i objekteve dhe personaliteteve të cilat i bënë DSORVP-ja , si dhe aktivitetet tjera të cilat në kompetencë të kësaj Drejtorie bëhet përmes:
 - 3.1. Sigurimit fizik duke qëndruar në pika statike;
 - 3.2. Kontrollleve fizike ose kontrolleve të cilat bëhen me pajisje elektronike me rastin e hyrje-daljeve të personave dhe automjeteve motorike;
 - 3.3. Identifikimit dhe evidentimit të personave/vizitorëve në vende apo objekte të ndryshme;
 - 3.4. Patrullimit dhe përcjelljes së personaliteteve të larta vendore dhe ndërkombëtare;
 - 3.5. Përcjelljes dhe sigurimit të delegacioneve të huaja.
4. DSORVP-ja, përmes personelit të saj i ndërmerr të gjitha veprimet dhe masat të cilat janë të nevojshme për sigurimin e pasurisë, objekteve dhe personelit i cili punon në këto objekte nga çfarëdo rreziku, duke mos u kufizuar vetëm në: sulmet e ndryshme, rrezikun nga zjarri, vjedhja, vandalizmi, prishja e rendit dhe qetësisë publike brenda objektit (nëse e thirren në ndihmë policinë) etj.
5. Personeli i DSORVP-së, gjatë kryerjes së detyrave zyrtare është i obliguar që sipas nevoje të bashkëpunojë me zyrtarë tjerë të Policisë, duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ Nr. 01/2012 Mënyrën e Kryerjes së Detyrave dhe Autorizimeve Policore.

Neni 49 **Personeli i DSORVP**

1. Zyrtarët policorë të DSORVP-së e kanë statusin e njëjtë sikurse të gjithë zyrtarët tjerë të Policisë, dhe se të gjitha rregullat, procedurat, drejtat, detyrat dhe autorizimet për këta zyrtarë policorë, përfshirë edhe çështjet e disiplinës janë të njëjta sikurse edhe zyrtarët tjerë të Policisë.
2. Zyrtarët policorë të DSORVP-së, detyrat dhe autorizimet e përgjithshme policore mund t'i kryejnë në uniformën policore dhe në rroba civile, duke iu përmbajtur akteve të brendshme të Policisë, të cilat e rregullojnë këtë çështje. Sigurimi fizik i objekteve zakonisht bëhet në uniformën policore, ndërsa sigurimi i brendshëm i objekteve dhe i personaliteteve të caktuara zakonisht bëhet në rroba civile.

Neni 50 **Detyrat dhe përgjegjësitë**

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e DSORVP-së dhe njësiteve të cilat sipas strukturës organizative janë në kuadër të saj janë të përcaktuara me akte të brendshme të Policisë.
2. Çdo objekt i cili sigurohet nga personeli i DSORVP-së duhet të posedoj përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësitë, të cilat duhet të përpilohen në bashkëpunim me personat përgjegjës të objektit përkatës, gjithnjë duke u bazuar me aktet e brendshme të Policisë dhe PSO-ve të kësaj Drejtorie, të cilat e rregullojnë këtë çështje.
3. Në kuadër të detyrave të përgjithshme të personelit të DSOVP-së hyjnë detyrat dhe autorizimet të cilat nuk kufizohen vetëm në:
 - 3.1. Detyrat parësore, të cilat janë siguria e personaliteteve dhe objekteve;

- 3.2. Të sigurohet që vetëm personeli i autorizuar të hyjë në objektet të cilat sigurohen;
- 3.3. Sigurimin fizik dhe përcjellja e personaliteteve të larta vendore, përcjelljen e delegacioneve të huaja;
- 3.4. Pas procedurave të vlerësimit të sigurisë së rrezikshmërisë e bën ekstradimin e personave të caktuar;
- 3.5. Kontrollimin e automjeteve, personave, valixheve, që zakonisht bëhet në hyrje të objektit dhe autoparkut i cili sigurohet;
- 3.6. Raportimin të mbikëqyrësi të çdo parregullsie të gjetur gjatë kryerjes së detyrës në sigurimin e objekteve, patrullimit, inspektimit dhe punëve tjera të cilat janë në kuadër të kësaj njësie.

Neni 51

Autorizimet me rastin e ndalimit dhe arrestimit

1. Zyrtari policor i DSORVP-së, i cili është në kryerje të detyrës, ka autorizim që ta ndalojë dhe ta arrestojë të dyshimtin në lokacionin apo objektin të cilin e siguron, dhe për këtë menjëherë ta informojë stacionin policor më të afërt, në mënyrë që sa më shpejt që të jetë e mundur mundshme të dërgohet njësi përkatëse që të merret me trajtimin e rastit.
2. Me rastin e dorëzimit të personit të arrestuar, apo sa më shpejt që të jetë e mundur pas dorëzimit të tij, zyrtari policor i DSORVP-së, i cili e ka bërë arrestimin është i obliguar që ta përpilojë dhe ta dorëzojë një raport me shkrim, në të cilin duhet të cekën arsyet e arrestimit.
3. Pas dorëzimit të personit të arrestuar, polici i DSORVP-së vazhdon me punën të cilën ka qenë duke e kryer.

Neni 52

Trajnimet e zyrtarëve policor të DSORVP-së

1. Me qëllim të aftësimit profesional, zyrtarët policorë të DSORVP-së marrin pjesë në trajnime, sipas niveleve përkatëse dhe nevojave të kësaj njësie. Këto trajnime organizohen nga Divizioni i Trajnimeve.
2. Pas identifikimit të nevojave për trajnimin e personelit të DSORVP-së, Divizioni i Trajnimeve në koordinim me Divizionin e Njësive të Specializuara përgatit dhe i realizon trajnimet adekuate për punonjësit e kësaj njësie.
3. Vlerësimi dhe testimi i zyrtarëve policorë të DSORVP-së, e posaçërisht Njësia për Mbrojtje të Afërt bëhet së paku një herë në vit. Nëse gjatë testimit zyrtari policor nuk tregon rezultate të mjaftueshme pozitive të standardeve operacionale, me rekomandimin e kompetentëve të kësaj njësie mund të transferohet prej kësaj njësie në një njësi tjetër.

KAPITULLI VII

INSPEKTIMI DHE AUDITIMI NË POLICINË E KOSOVËS

Neni 53

Inspektimi

Policia e Kosovës për tu siguruar që puna e personelit policor dhe e të gjitha njësive organizative, kryhet në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi, përcakton inspektim dhe standarde të tij. Nëpërmjet inspektimit arrihet që të avancohen standardet unike të punës dhe të menaxhohen në mënyre sa më efikase dhe efektive burimet njerëzore dhe ato materiale në kuadër të Policisë. Gjithmonë kur inspektimi has në parregullsi dhe keq menaxhim duhet të përpilojë raporte dhe të rekomandojë për hapat që duhet ndërmarrë në mënyrë që të mënjanohen këto shkelje dhe procedura që duhet ndjekur në të ardhmen.

Neni 54

Kushtet e përgjithshme

1. Veprimtaria inspektuese ka të bëjë me kontrollimin dhe mënyrën e menaxhimit dhe të kualitetit të punës dhe të sigurohet se veprimtaritë policore janë duke u kryer në pajtim me ligjet dhe aktet nënligjore.
2. Ta mbikëqyrë në mënyrë të drejtpërdrejtë mënyrën dhe procedurat e zbatimit të vendimeve, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.
3. Personelit të Njesisë së Inspektimit duhet t'u lejohej të kenë qasje të pakufizuar në të gjitha fushat e veprimtarisë policore, në të gjitha të dhënat, për personelin, pasuritë dhe objektet, si dhe është i autorizuar të inspektojë me kërkesë të drejtorit të Përgjithshëm të Policisë.
4. Në rastet kur nevojitet qasje-inspektim në dokumentet që janë të shënuara si të klasifikuara, zyrtari i inspektimit, domosdo duhet ta posedojë lejen e sigurisë të lëshuar nga Agjencia e Kosovës për Inteligjencë.
5. Inspektimi duhet ta përpilojë raportin me shkrim për të gjeturat. Raporti duhet t'i përmbajë detajet e inspektimit, lëshimet që janë identifikuar dhe rekomandimet për mënjanimin e parregullsive që janë hasur gjatë inspektimit.

Neni 55

Identifikimi i Njesisë së inspektimit

Zyrtarët e inspektimit pajisen me kartela identifikimi për inspektim dhe se të njëjtat do t'i prezantojnë para çdo inspektimi.

Neni 56

Auditimi

Auditimi është veprimtari e njësisë përkatëse të Policisë me të cilin synohet vendosja e një efikasiteti më të madh operacional, një disiplinë më të madhe buxhetore dhe fiskale si dhe respektimi i rregullave në Policinë e Kosovës, duke kërkuar që veprimtaritë, të dhënat si dhe

sistemet e menaxhimit dhe kontrollit të të gjitha departamenteve dhe njësive organizative të Policisë do t'i nënshtrohen auditimit të brendshëm sistematik dhe gjithëpërfshirës.

Neni 57

Qasje e auditorëve të brendshëm

1. Zyrtarët e auditimit të brendshëm kanë qasje të plotë, të lirë dhe të pakufizuar në të gjitha veprimet, të dhënat, pronat dhe personelin, në kuadër të Policisë së Kosovës.
2. Të gjitha njësitë organizative të Policisë duhet të sigurojnë bashkëpunim të plotë për të vënë në dispozicion çfarëdo materiali apo informate të kërkuar nga zyrtari i auditimit të brendshëm, apo që është relevante për auditim.
3. Kur ekzistojnë shqetësime për materiale të kufizuara, mbikëqyrësi i auditimit të brendshëm do të bëjë aranzhime me zyrtarin e njësitetit përkatës për të siguruar që vetëm zyrtari i auditimit të brendshëm veçanërisht i autorizuar të merret me materialin e kufizuar.
4. Në rastet kur nevojitet qasje-auditim në dokumentet që janë të shënuara si të klasifikuara, zyrtari i auditimit të brendshëm, domosdo duhet ta posedojë lejen e sigurisë të lëshuar nga Agjencia e Kosovës për Inteligjencë.

Neni 58

Funksionimi i njësive për auditim të brendshëm

1. Menaxhmenti i lartë i Policisë është përgjegjës për zbatimin dhe funksionimin efektiv të auditimit të brendshëm në pajtim me kërkesat e Ligjit për auditimin e brendshëm dhe të kësaj rregulloreje.
2. Përgjegjësia e vendosur në paragrafin 1 të këtij neni për zbatimin e funksionit të auditimit të brendshëm, shtrihet në tërë Policinë, përfshirë të gjitha njësitë organizative të saj.
3. Njësia e pavarur e auditimit të brendshëm përbëhet nga shefi i Njesisë së auditimit të brendshëm dhe auditorët e brendshëm me mbështetje të duhur administrative. Njësia e auditimit të brendshëm është drejtpërdrejt në vartësi të drejtorit të Përgjithshëm të Policisë.
4. Të gjithë personat duhet që të bashkëpunojnë plotësisht dhe në mënyrë të rregullt me Njësinë e auditimit të brendshëm si dhe të lejojnë qasje në të gjitha sistemet dhe dokumentet sipas kërkesës, pa të drejtë refuzimi.
5. Njësia për auditim të brendshëm dhe secili auditor i brendshëm duhet t'i ushtrojë aktivitetet e veta në pajtim me:
 - 5.1. Ligjin për auditimin e brendshëm dhe ligjet e tjera të zbatueshme në Kosovë;
 - 5.2. Rregullat, politikat, doracakët, udhëzimet, statuti i auditimit të brendshëm dhe Kodin e etikës.

Neni 59

Objektivat e auditimit të brendshëm

1. Objektivat e auditimit të brendshëm janë:
 - 1.1. Identifikimi i sistemeve të menaxhimit të rrezikut dhe kontrollit,
 - 1.2. Vlerësimi i sistemeve të menaxhimit të rrezikut dhe kontrollit,
 - 1.3. Vlerësimi i efektivitetit të kontrollit duke promovuar përmirësim të vazhdueshëm;
2. Vlerësimi i përshtatshmërisë dhe efikasitetit të kontrollit të përfshirë në qeverisjen, veprimet dhe sistemet e informimit të organizatës. Këtu përfshihet vlerësimi i procesit që siguron:
 - 2.1. Besueshmëri dhe integritet të informatave financiare dhe operative;
 - 2.2. Efektivitet dhe efikasitet të veprimeve;
 - 2.3. Ruajtje të pasurive;
 - 2.4. Pajtueshmëri me ligjet, rregulloret dhe kontratat.
3. Vlerësimin dhe zhvillimin e rekomandimeve mbi përmirësimin e procesit të qeverisjes në sigurimin e menaxhimit të performancës efektive, organizative dhe llogaridhënien, si dhe ta mbikëqyrë në mënyrë të drejtpërdrejtë mënyrën dhe procedurat e zbatimit të vendimeve, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Neni 60

Komiteti i auditimit

1. Komiteti i auditimit është organ i pavarur këshillëdhënës për menaxhmentin e lartë dhe mbështetës për auditorët e brendshëm, duke:
 - 1.1. siguruar një mbikëqyrje të planeve dhe rezultateve të auditimit;
 - 1.2. siguruar pavarësinë e auditorit të Brendshëm;
 - 1.3. vlerësuar përshtatshmërinë e burimeve të auditimit;
 - 1.4. siguruar që rekomandimet e auditimit janë pranuar dhe zbatuar;
 - 1.5. këshilluar mbi çështjet lidhur me rreziqet, sistemet e kontrollit të brendshëm dhe auditimit.
2. Komiteti i Auditimit të Brendshëm krijohet nga menaxhmenti i lartë.
3. Komiteti i auditimit duhet që për një periudhë prej së paku shtatë (7) vjetësh të mirëmbajë shënime për të gjitha procedimet e tij bashkë me të gjitha raportet e ofruara nga auditimi i brendshëm sikur edhe shënime gjithëpërfshirëse të shkruara në lidhje me të gjitha çështjet dhe dëshmitë që kanë të bëjnë me ato raporte dhe të gjitha veprimet e ndërmarra nga Komiteti i auditimit si përgjigje në ato raporte.
4. Qasje të plotë dhe të papenguar në këto dokumente mund të kenë, auditori gjeneral dhe çdo autoritet tjetër publik që ka funksion hetues apo kontrollues.

Neni 61

Mbrojtja e auditorëve të brendshëm

Drejtori i Përgjithshëm i Policisë dhe Komiteti i auditimit i Ministrisë së Punëve të Brendshme, duhet të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pavarësinë e zyrtareve të auditimit të brendshëm dhe që menjëherë të ndërmerren masa në rast të shkaktit të pengesave nga cilido person në punën e Njesisë së Auditimit të Brendshëm ose Auditorit të Brendshëm për kryerjen e një auditimi të brendshëm sipas ligjit dhe akteve nënligjore.

Neni 62 **Konflikti i interesit**

Çdo auditor i brendshëm do të njoftojë me shkrim shefin e Njesisë së auditimit të brendshëm për ndonjë konflikt aktual apo potencial të interesit i cili mund të dalë nga një detyrë e auditimit. Pas njoftimit të konfliktit të tillë Shefi i Njesisë së Auditimit të Brendshëm do të ri-caktojë auditorin e brendshëm në detyra të tjera ku ai/ajo nuk ka konflikt interesi.

Neni 63 **Shefi i Njesisë për auditim të brendshëm**

1. Njësia për auditim të brendshëm në kuadër të Policisë së Kosovës udhëhiqet nga shefi i njësisë. Shefi i njësisë njëkohësisht është edhe Auditor i Brendshëm.
2. Shefi i Njesisë së auditimit të brendshëm është përgjegjës për:
 - 2.1. Menaxhimin dhe mbikëqyrjen e personelit dhe veprimtarisë së Njesisë për auditim të brendshëm;
 - 2.2. Zbatimin adekuat dhe respektimin e ligjeve dhe akteve nënligjore;
 - 2.3. Përgatitjen dhe dorëzimin me kohë të planit strategjik të auditimit në bazë të vlerësimit të rrezikut për rishikim dhe miratim tek menaxhmenti i lartë i subjektit të sektorit publik dhe Komiteti i auditimit;
 - 2.4. Organizimin, kryerjen, mbikëqyrjen dhe ushtrimin e të gjitha aktiviteteve të auditimit të brendshëm të ndërmarra nga Njësia e auditimit të brendshëm;
 - 2.5. Përgatitjen dhe dorëzimin e raporteve tremujore dhe vjetore për të gjitha aktivitetet e auditimit të Njesisë së auditimit të brendshëm;
 - 2.6. Dorëzimin e planit vjetor dhe strategjik të auditimit të brendshëm tek NJQH jo më vonë se deri me 31 tetor të secilit vit kalendarik pas miratimit nga menaxhmenti i lartë i SSP dhe Komiteti i auditimit;
 - 2.7. Mirëmbajtjen e të gjitha dosjeve të raporteve të auditimit, shënimeve gjithëpërfshirëse të shkruara në lidhje me të gjitha çështjet, dëshmitë që kanë të bëjnë me ato raporte dhe të gjitha rekomandimet e dhëna menaxhmentit të lartë të SSP dhe Komitetit të auditimit, të cilat duhet të ruhen së paku 7 (shtatë) vjet;
 - 2.8. Planifikimin për zhvillimin e vazhdueshëm profesional të personelit të Njesisë.
3. Për parregullsitë e identifikuara gjatë auditimit, shefi i Njesisë së auditimit të brendshëm përcakton afate për mënjanimin e tyre dhe për arritjen e nivelit të dëshiruar. Këto afate caktohen varësisht nga natyra e parregullsive dhe e shkeljeve të identifikuara gjatë auditimit.

4. Mosrespektimi i afateve të caktuara për mënjanimin e këtyre parregullsive mund të jetë shkas për inicim të procedurës disiplinore nga ana e kësaj njësie. Autoritet i procedimit të raporteve të auditimit është drejtori i Përgjithshëm i Policisë.

Neni 64 **Identifikimi i Njesisë së auditimit**

Shefi dhe zyrtarët e auditimit do të pajisen me kartela identifikimi për auditim dhe se të njëjtat do t'i prezantojnë para çdo auditimi.

KAPITULLI VIII **MJETET EKSPLOZIVE, KËRCËNIMET ME BOMBË DHE MATERIE TË** **RREZIKSHME**

Neni 65 **Mjetet eksplozive**

Zyrtarët policorë për përmbushje të suksesshme të detyrave zyrtare duhet të përfillin rregulla dhe udhëzime përkatëse për mënyrën e trajtimit të mjeteve eksplozive, kërcënimeve me bombë dhe veprimit me materie të rrezikshme, në atë mënyrë që të ofrohet siguri maksimale për zyrtarët policorë dhe qytetarët në përgjithësi.

Neni 66 **Përgjegjësitë e qendrës së komunikimit**

1. Zyrtari policor i qendrës së komunikimit, të gjitha informatat e paraqitjes së incidenteve me mjete eksplozive dhe mjeteve tjera të rrezikshme duhet t'i trajtojë seriozisht dhe t'iu kushtojë rëndësi veçmas rrethanave të paraqitura.
2. Kur bëhet paraqitja me telefon e kërcënimit me bombë nga qendra e komunikimit duhet të merren informatat vijuese:
 - 2.1. Vendin e saktë të kërcënimit
 - 2.2. Emrin, numrat e telefonave dhe vendin ku ndodhet personi që raporton kërcënimin;
 - 2.3. Personin (rojtarin e sigurimit, pronarin e firmës, nëpunësin e zyrës etj.) që ka bërë pranimin e thirrjes, nëse ai vetë nuk ka bërë thirrjen;
 - 2.4. Përshkrimin e saktë të kërcënimit;
 - 2.5. Si është pranuar kërcënimi (me telefon, letër, e-mail etj.);
 - 2.6. Gjininë dhe moshën (e përafërt) e personit që e bën kërcënimin;
 - 2.7. Tonin e zërit të personit që e bën kërcënimin (i shqetësuar, mllefosur, kërcënues etj.);
 - 2.8. Informatën mbi tipin e mjetit, nëse dihet;
 - 2.9. A ka vende ku ka qasje masa e gjerë në vendin e kërcënimit;
 - 2.10. A ka ndonjë person të sigurimit në lokacionin në fjalë;
 - 2.11. A ka ndonjë kamerë sigurie të vendosur afër objektit;
 - 2.12. Personel të mundshëm të mirëmbajtjes, i cili mund të njohë planin e ndërtesës si dhe vendet e dëmtimit të lartë të mundshëm;

2.13. Vendin në të cilin polici përgjegjës duhet të takohet me personelin apo administratorin e ndërtesës; dhe

2.14. Të mbahet në linjë telefonike thirrësi nëse është e mundur.

3. Zyrtari policor i qendrës së komunikimit pas pranimit të informatave të nevojshme lidhur me kërcënimin duhet të njoftojë njësitë përkatëse për reagim.

3.1. Të njoftojë njësitë patrulluese/sectoriale për sigurimin e vendit të ngjarjes;

3.2. Të njoftojë ekspertët e njësitit IEDD;

3.3. Të njoftojë njësinë K-9 me qen nuhatës për eksploziv;

3.4. Të njoftojë njësitë e zjarrfikësve; dhe

3.5. Të njoftojë ambulancën.

4. Kur bëhet paraqitja me telefon e shpërthimeve (eksplodimeve) nga qendra e komunikimit duhet të merren informatat vijuese:

4.1. Vendin në të cilin ka ndodhur shpërthimi;

4.2. Informatat mbi materien shpërthyesë nëse dihen (eksploziv, bombola gazi, gypa avujsh, shpërthime kimike, etj.);

4.3. Informatat mbi personat e lënduar dhe të vdekur;

4.4. Informatat mbi dëmet e shkaktuara nga shpërthimi;

4.5. Emrin, numrat e telefonave dhe vendin ku ndodhet personi që raporton shpërthimin;

4.6. Çdo fakt apo informacion tjetër relevant lidhur me rastin.

5. Zyrtari policor i qendrës së komunikimit pas pranimit të informatave të nevojshme lidhur me eksplozimin duhet të njoftojë:

5.1. Njësitë patrulluese/sectoriale për sigurim të vendit të ngjarjes;

5.2. Ekspertët e njësitit IEDD;

5.3. Hetimet dhe Krim teknikën e rajonit përkatës;

5.4. Njësitë e zjarrfikësve nëse është e nevojshme; dhe

5.5. Ambulancën nëse është e nevojshme.

6. Kur bëhet paraqitja me telefon e mjeteve eksplozuese apo materieve të rrezikshme nga qendra e komunikimit duhet të merren informatat vijuese:

Përshkrimin e saktë të mjetit apo materies së gjetur;

6.1. Vendi në të cilin është gjetur;

6.2. Emrin, numrat e telefonave dhe vendin ku ndodhet personi që raporton mjetin eksplozues;

6.3. Të marrë sa më shumë informata lidhur me identifikimin e mjetit eksplozues; dhe

6.4. Faktet apo informacionet tjera relevante lidhur me rastin.

7. Zyrtari policor i qendrës së komunikimit pas pranimit të informatave të nevojshme lidhur me gjetjen e mjeteve të rrezikshme apo eksplozuese duhet të:

7.1. Të njoftojë njësitë patrulluese/sectoriale për sigurim të vendit të ngjarjes

7.2. Të njoftojë ekspertët e njësitit IEDD për të kontrolluar dhe trajtuar mjetet eksplozuese të cilat kanë prapavijë kriminale apo terroriste;

7.3. Të njoftojë njësitë e FSK-së për të kontrolluar dhe trajtuar fushat e minuara dhe mjetet e rrezikshme dhe eksplozuese të cilat kanë mbetur nga lufta;

7.4. Të dërgojë njësitë e zjarrfikësve dhe ambulancën në vendngjarje nëse është e nevojshme.

Neni 67

Procedurat në vendin e ngjarjes

1. Zyrtari i parë policor reagues menjëherë pas arritjes në vendin e ngjarjes duhet:
 - 1.1. Të afrohet me kujdes të lartë në vendngjarje;
 - 1.2. Të informojë dhe të raportojë tek qendra e komunikimit në lidhje me rastin;
 - 1.3. Të vendosë dhe të sigurojë perimetrin përkatës në vendin, në të cilin është krijuar situata emergjente;
 - 1.4. Të kontaktojë dhe të marrë informata nga personi përgjegjës i ndërtesës apo personi që ka lajmëruar rastin;
 - 1.5. Të fillojë evakuimin e të gjithë personave nga vendi i incidentit;
 - 1.6. Të orientojë trafikun e automjeteve dhe këmbësorëve në drejtim të sigurt;
 - 1.7. Të kujdeset për personat e lënduar dhe të asistojë ekipet mjekësore;
 - 1.8. Të ndërpresë rrjedhjen e gazit në valvulën kryesore furnizuese nëse ekziston;
 - 1.9. Të sugjerojë banorët t'i hapin dyert dhe dritaret në mënyrë që të shmanget dëmtimi i panevojshëm i pasurisë nëse ekziston rreziku për shpërthim;
 - 1.10. Të njoftojë mbikëqyrësin ose të sigurohet se ai është në rrugë për në vendin e ngjarjes për ta udhëhequr incidentin;
 - 1.11. Të konstatojë se a ekziston kërcënim i drejtpërdrejtë për jetën dhe/ose pasurinë;
 - 1.12. Të marrë informata për vendin dhe kohën e lajmëruar të shpërthimit;
 - 1.13. Të ndalojë hyrjen në vendin e ngjarjes të të gjithë personave të pa autorizuar pa dallim grade apo pozite deri në arritjen e njësive përkatëse;
 - 1.14. Të mbajë evidencë për të gjithë personat të cilët hyjnë në vendngjarje;
 - 1.15. Të informojë ekspertet e njësimit IEDD në detaje lidhur me rastin;
 - 1.16. Të asistojë ekipet e njësisë IEDD deri në përfundim të operacionit;
 - 1.17. Të bashkëpunojë me agjencitë tjera prezente në vendin e ngjarjes; dhe
 - 1.18. Të sigurohet se rruga afër vendit të incidentit është e hapur për arritjen e njësive reaguese;
 - 1.19. Të jetë i vetëdijshëm për mundësinë e ekzistimit të një mjeti tjetër të rrezikshëm në vendngjarje (rregulli 1+1).
2. Mbikëqyrësi me gradë më të lartë në vendngjarje duhet:
 - 2.1. Të komandojë dhe udhëheq me vendin e incidentit deri në arritjen e ekspertëve të njësimit IEDD;
 - 2.2. Të jetë përgjegjës për vendngjarje (komandant incidenti), si dhe për aktivitetet e evakuimit, sigurimit dhe përcjelljes së qarkullimit të trafikut;
 - 2.3. Të shpërndajë zyrtarët policorë e tij për të njoftuar banorët e ndërtesave përreth mbi rrezikun e mundshëm;
 - 2.4. Të sigurohet se janë prezentë të gjitha shërbimet e nevojshme në vendin e ngjarjes siç janë zjarrfikësit, personeli mjekësor, etj.;
 - 2.5. Të sigurojë dhe përcaktojë një lokacion të sigurt larg mjetit shpërthyes, në rast të evakuimit;

- 2.6. Të tërheqë vëmendjen për rrezik vjedhje personit kompetent të ndërtesës gjatë evakuimit;
- 2.7. Të vendosë personel të mjaftueshëm që të mos lejohet hyrja e personave të paautorizuar në ndërtesë derisa ajo të jetë e sigurt; dhe
- 2.8. Të caktojë njësitë patrulluese në sigurim të vendit të ngjarjes deri në përfundim, nëse për shkak të kushteve jo të përshtatshme (mungese ndriçimi, kushteve klimatike etj.) nevojitet shtyrja e operacionit.

Neni 68

Evakuimi

1. Evakuimi i banorëve të rrezikuar nga mjetet eksplozive dhe materiet e rrezikshme bëhet atëherë kur me masa tjera nuk mund të garantohet siguria e tyre.
 - 1.1. Nëse nuk është saktësuar vendi i mjetit apo kërcënimit me eksploziv duhet evakuuar gjithë ndërtesa.
 - 1.2. Distanca për evakuim duhet të bazohen në kartën identifikuese për distancat e sigurisë së mjeteve eksplozive.
2. Nëse përreth vendit ku ka ndodhur shpërthimi apo është lajmëruar kërcënim me bombë, gjenden ndërtesa me mure të forta atëherë distanca e evakuimit mund të shkurtohet.
3. Nëse mbikëqyrësi në vendin e ngjarjes nuk është i sigurt për distancën e evakuimit atëherë duhet të konsultohet me udhëheqësin e njësisë IEDD për hapat e mëtejme dhe distancën e evakuimit deri në arritjen e tyre.
4. Komandanti i incidentit vetëm pas rekomandimit të udhëheqësit të njësisë IEDD në vendngjarje mund të urdhërojë kthimin e banorëve në ndërtesën e evakuuar pasi të jetë siguruar se nuk ekziston ndonjë rrezik apo kërcënim për sigurinë e tyre.

Neni 69

Përgjegjësitë e njësive për reagim

1. Njësia për Trajtimin e Mjeteve të Improvizuara Eksplozive (në tekstin e mëtejme: IEDD) e Policisë së Kosovës angazhohet në rastet e:
 - 1.1. Kërcënimeve me bombë;
 - 1.2. Mjeteve eksplozive dhe bombave me prapavijë kriminale dhe terroriste;
 - 1.3. Të gjitha llojet e shpërthimeve;
 - 1.4. Rasteve kur personat e dyshuar posedojnë, shesin apo në ndonjë mënyrë tjetër përdorin mjete eksplozive dhe materie tjera të rrezikshme;
 - 1.5. Incidenteve, kërcënimeve dhe sulmeve me armë të shkatërrimit në masë (kimike, biologjike, nukleare dhe radioaktive).
2. Njësitë e Deminimit (EOD) dhe Njësia për Mbrojtje Kimike, Atomike dhe Biologjike (MKAB) e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) angazhohen në rastet e:
 - 2.1. Fushave të minuara;
 - 2.2. Mjeteve të pashpërthyer ushtarake të mbetura pas lufte;

- 2.3. Trajtimit të mbetjeve dhe materieve kimike, biologjike, nukleare dhe radioaktive dhe
- 2.4. Në rastet tjera kur kërkohet mbështetja e FSK-së sipas Memorandumit të Mirëkuptimit në mes të MFSK-MPB.

Neni 70

Kontrollimet për gjetjen e mjeteve eksplozive

1. Vetëm ekspertët për trajtimin e mjeteve eksplozive IEDD duhet të kontrollojnë apo ndërmarrin aksione për gjetjen dhe identifikimin e mjeteve eksplozive dhe materieve tjera të rrezikshme në vendin e ngjarjes.
2. Përjashtimisht kontrolli për gjetjen e eksplozivit me qen nuhatës (K-9) lejohet nëse bëhet nën mbikëqyrjen e ekspertëve për trajtimin e mjeteve eksplozive IEDD.

Neni 71

Mënyrat e komunikimit në incidentet me mjete eksplozive

1. Përdorimi i radiolidhjeve dhe telefonave për komunikim duhet të minimizohen dhe të lejohen vetëm nëse është e domosdoshme.
2. Distanca minimale për komunikim në incidentet me mjet eksploziv është 50 metra nga vendi i dyshuar për mjet eksplozives.
3. Gjatë kohës kur bëhen kontrollimet apo çmontimi i një mjeti të dyshuar, komunikimet duhet të bëhen vetëm me telefon, nëse është e mundur.

Neni 72

Veprimet lidhur me operacionet me mjete eksplozive

1. Të gjitha vendimet lidhur me mënyrën e trajtimit të mjeteve eksplozive në vendngjarje janë përgjegjësi ekskluzive e udhëheqësit të operacionit të njësisë IEDD.
2. Bllokimi i frekuencave për të pamundësuar aktivizimin e mjeteve eksplozive duhet të bëhet në përputhje me PSO-në mbi përdorimin e bllokuesit të frekuencave.

Neni 73

Kufizimet lidhur me operacionet me mjete eksplozive

1. Nuk mund të fillohet me procesin e trajtimit të mjetit eksploziv nëse rrezikohen personat tjerë në vendin e ngjarjes.
2. Në asnjë rrethanë nuk guxon të lejohet kthimi i personave të evakuuar para se të shpallet nga komandanti i incidentit se procesi i neutralizimit ka mbaruar.
3. E njëjta gjë vlen edhe për moslejimin e asnjë zyrtari policor brenda perimetrit të sigurisë para se të shpallet nga komandanti i incidentit se procesi i neutralizimit ka mbaruar.

4. Trajtimi i mjetit eksploziv dhe vend-shikimi i vendit të ngjarjes pas shpërthimit duhet të bëhet në kushte të ndriçimit natyral përveç nëse kërkohet intervenim i menjëhershëm për mbrojtjen e drejtpërdrejtë të jetës dhe pasurisë së qytetarëve.

Neni 74

Materiet radioaktive

1. Materie radioaktive mund të paktohen dhe të transportohen vetëm në ambalazh të dedikuar për lloj të caktuar të materieve radioaktive, varësisht nga madhësia dhe fuqia e burimit, gjendja agregate dhe cilësitë tjera të materies radioaktive. Doza e rrezatimit të sipërfaqes së ambalazhit dhe të distancës së caktuar nga ambalazhi dhe niveli i kontaminimit të sipërfaqes së ambalazhit nuk guxojnë të jenë më të mëdha nga shumatat e përcaktuara për tipin përkatës dhe kategoria e paketimit të parashikuara me dispozitat për mbrojtjen nga rrezatimi jonizues.

2. Nëse gjatë kontrollimeve kufitare polici apo doganieri konstaton ose në ndonjë mënyrë tjetër zbulon prezencën e materieve të rrezikshme, transporti i së cilës është i ndaluar, është i obliguar që menjëherë ta ndalojë transportin e mëtutjeshëm dhe të veprojë në bazë të udhëzimeve për Veprimin me Materie të Rrezikshme.

3. Nëse materiet radioaktive të cilat transportohen klasifikohen në grupin e materieve me prezencë natyrale, atëherë lejohet qarkullimi i tyre pasi të vërtetohet se posedojnë të gjitha dokumentacionet e rregullta.

4. Agjencia e Kosovës për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguria Bërthamore duhet të njoftohet për të gjitha rastet me materie radioaktive.

Neni 75

Aksidentet me materie radioaktive

1. Persona juridikë ose fizikë të cilët transportojnë materie të rrezikshme janë të detyruar, që në rast të humbjes së materies së rrezikshme gjatë transportimit, t'i ndërmarrin masat e nevojshme për gjetjen e saj dhe për rrezikun që paraqet materia e rrezikshme ta njoftojnë stacionin më të afërt policor ose organin kompetent i cili e ka lëshuar lejen për transportimin e materieve të rrezikshme përkatësisht inspektoratin përkatës, në varshmëri nga lloji i materies së rrezikshme.

2. Në çfarëdo aksidenti, qoftë automobilistik, ajror apo industrial, ku janë të involvuara materiet radioaktive, personeli i emergjencës duhet të vejë simbolin dhe shenjat në automjete në mënyrë që të vërtetohet prezenca apo jo prezenca e materialeve radioaktive.

3. Nëse është e nevojshme të lënduarit të zhvendosen në një vend më të sigurt për trajtim të nevojshëm dhe vlerësim të personelit mjekësor. Zhvendosja e mëtutjeshme mund të bëhet vetëm nëse kërkohet menjëherë për të shpëtuar jetën e viktimës. Nëse viktimat duhet të dërgohen në spital, qendra e informimit duhet ta njoftojë spitalin, se personat e lënduar janë të kontaminuar me materie radioaktive.

4. Të kufizohet vendngjarja e aksidentit me një perimetër sa më të gjerë që është e mundur, që do të jetë zonë e ndaluar. Në zonën e ndaluar mund të hyjnë vetëm personeli i kërkuar dhe personeli emergjent përgjegjës radiologjik.

Neni 76 **Kujdesi ndaj qytetarëve**

1. Në të gjitha incidentet me mjete të rrezikshme dhe radioaktive kujdesi ndaj qytetarëve duhet të jetë primar.
2. Duhet të mbahen dhe ndalen ata persona që kanë mundur të kenë kontakt me materie radioaktive derisa të ekzaminohen nga personeli emergjent përgjegjës radiologjik. Kurdo që është e mundur duhet t’iu merren emrat dhe adresat e personave, të cilët janë të involvuar për trajtim të mundshëm mjekësor më vonë.
3. Duhet të mbahet kontakti me radio me Qendrën e Komunikimit derisa të arrin personeli i reagimit emergjent radiologjik, dhe po ashtu mund të pranohen instruksionet lidhur me veprimet që duhet të merren për aksidentin.
4. Largimi - “Pastrimin” - Mos tentoni që të largoni gjëra apo ta pastroni vendin e aksidentit ku është i involvuar materiali radioaktiv, përveç në raste kur këshilloheni nga personeli emergjent radiologjik.
5. Dekontaminimi - personeli i reagimit emergjent radiologjik duhet t’i kontrollojë të gjithë ata që janë apo dyshohet të kenë qenë të ekspozuar nga materiali radioaktiv sa më parë që është e mundur dhe të bëhet dekontaminimi i tyre.

Neni 77 **Koordinimi me agjencitë tjera**

1. Policia e Kosovës, kur ka të bëjë me materiale të rrezikshme, domosdo duhet që të bashkëpunojë me Agjencinë e Kosovës për Mbrojtje nga Rrezatim dhe Siguria Bërthamore (AKMRRSB), Doganën e Kosovës, Agjencinë për Menaxhim Emergjent (AME), Shërbimet e Zjarrfikësve dhe Shërbimet Emergjente Mjekësore, për të ofruar reagim të shpejtë në trajtim të sigurt të incidenteve ku janë të involvuara materialet e rrezikshme dhe të mbrohet popullata dhe ambienti nga kontaktet me materie të dëmshme.
2. Nëse gjatë transportit të materies së rrezikshme, ndodh çfarëdo lloj incidenti, polici ndërlidhës (përgjegjës për përcjellje) kërkon asistencë nga stacioni policor në territorin e të cilit ka ndodhur incidenti.
3. Njësia që i përgjigjet rastit duhet të përcaktojë llojin dhe formën e materialit të involvuar, si dhe të sigurojë fletë-dëshminë e ngarkesës, pllakatet dhe etiketat në pjesën e jashtme të mjetit motorik dhe/apo kontejnerëve.

4. Komandanti i ndërrimit ose polici përgjegjës në vendngjarje duhet ta informojë qendrën e komunikimit që menjëherë të njoftojë Shërbimin e Zjarrfikësve dhe agjencitë tjera varësisht nga lloji i incidentit dhe të kërkojë ndihmën e tyre.
5. Nëse incidenti shkakton rrezik për banorët e afërt, policët duhet të fillojnë procesin e evakuimit.
6. Emrat e të evokuarve dhe strehimeve të përkohshme duhet të shënohen në një regjistër nga ana e policit përgjegjës në vendngjarje.
7. Të bëhet një kordon jashtë vendit duke mundur distancë të sigurt nga vendi i incidentit. Kjo informatë është në librin e udhëzimeve të qendrës së komunikimit.
8. Të ridrejtohet i tërë trafiku dhe t'u lejohet hyrja vetëm punonjësve të emergjencës që ofrojnë ndihmë në vendngjarje, evakuim dhe shpëtim.
9. Po ashtu, gjatë gjithë kohës së incidentit, agjencitë e zbatimit të ligjit do të koordinojnë dhe bashkëpunojnë në përputhje me Planin e Reagimit Kombëtar dhe Menaxhimin të Integruar të Emergjencave.

Neni 78 **Raporti me media**

Komandanti në vend të ngjarjes duhet të sigurojë një lokacion të sigurt afër vendit të komandës për të gjitha mjetet e informimit publik. Të gjitha informatat e lëshuara duhet më parë të aprovohen dhe të jenë në përputhje me udhëzimet e hartuara në rregulloren për bashkëpunimin e Policisë me media.

Neni 79 **Procedurat standarde të operimit**

1. Departamentet, divizionet, drejtorit, dhe njësiteve tjera organizative të cilat janë në kuadër të Policisë do të hartojnë Procedura Standarde të Operimit (PSO), me të cilat më hollësisht do të përcaktohen rregullat dhe procedurat që kanë të bëjnë me fushën e caktuar si: patrullimin, mbajtjen dhe ruajtjen e armëve policore, arrestimin dhe ndalimin policor, transportimin e personave të dyshimtë, trajtimi i personave me aftësi të kufizuar dhe fëmijëve, sigurimi i objekteve dhe personaliteteve, trajtimi i mjeteve shpërthyes dhe mjeteve tjera të rrezikshme, inspektim dhe auditimi, si dhe çështjet tjera të cilat kanë të bëjnë çështjet policore operative.
2. PSO-të iu shërbejnë zyrtarëve policorë, si lehtësim për t'i kryer me sukses, profesionalizëm dhe efikasitet punët nga fushëveprimi i tyre.
3. Autoriteti miratues i PSO-ve të cilat janë në kuadër të Departamentit është Drejtori i Departamentit përkatës, ndërsa nëse PSO-ja është në nivel të divizionit apo drejtorisë, autoriteti miratues është drejtori i divizionit apo drejtorisë, varësisht për cilën njësi vlen.

4. Nëse PSO-ja i dedikohen dy apo më shumë departamenteve, drejtorive apo njësiteve tjera organizative të cilat janë nën autoritetin e zëvendës drejtorit, atëherë autoriteti miratues është Zëvendës drejtori i Përgjithshëm.

KAPITULLI IX DISPOZITAT SHFUQIZUESE

Neni 80 Shfuqizimi i rregulloreve

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje, shfuqizohen rregulloret si në vijim:

1. Rregullorja nr. 26-2015 për patrullim;
2. Rregullorja nr. 11-2015 për Dhënien, Bartjen dhe Përdorimin e Armës Zyrtare;
3. Rregullorja nr. 16-2015 për arrestimin e përkohshëm dhe ndalimin policor të personave madhorë dhe të miturve;
4. Rregullorja nr. 24-2015 për trajtimin e personave me aftësi të kufizuara;
5. Rregullorja nr. 25-2015 për mbrojtjen dhe trajtimin e fëmijëve në procedurë policore;
6. Rregullorja nr. 22-2015 për Drejtorinë për Sigurimin e Objekteve me Rendësi të Veçantë dhe të Personaliteteve;
7. Rregullorja nr. 06-2015 për Inspektimin në Policinë e Kosovës;
8. Rregullorja nr. 07-2015 për Auditimin e Brendshëm në Policinë e Kosovës.
9. Rregullorja nr. 15-2015 për mjetet eksplozive, kërcënimet me bombë dhe materiet e rrezikshme;

Neni 81 Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas nënshkrimit nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë.

z. Shpend Maxhuni



Drejtor i Përgjithshëm i Policisë



Data: 11 / 04 / 2017